



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 15, datë 30.01.2025

P Ë R

CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE “VËREJTJE PUBLIKE” NDAJ MAGJISTRATIT
KLEDIAN LLAHO , ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM SARANDË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenet 148/d, pika 1, 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, shkronja "b", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 102, pika 2, shkronja “ç” dhe “d”, 105, 115, 141, 142 dhe 146, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 159, pikat 1, 2, shkronja “b”, 161, 189, pika 1, shkronja "a", 190, pikat 1 dhe 2 dhe 192, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shqyrtoi Kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor sipas Shkresës Nr. 2292/6, datë 13.12.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që i përket palëve:

KËRKUES:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani

SUBJEKT I PROCEDIMIT:

Z. Kledian Llaho, me detyrë Drejtues/prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; (Në mungesë në shpallje)

OBJEKTI:

Procedimi disiplinor ndaj magjistratit z. Kledian Llaho, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “ç” dhe “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



-Propozimi i masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një afat një vit”, e parashikuar nga neni 108 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “ç” dhe “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.


Këshilli, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, shqyrtoi çështjen në përputhje me parashikimet e neneve 142 dhe vijues, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*më tej, Ligji për Statusin*) dhe dëgjoi:

- Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (*më tej, Inspektori*), përfaqësuar nga Inspektor Erjena Bashari, e cila përfundimisht kërkoi: Pranimin e kërkesës së paraqitur për dhënie masë disiplinore.
- Magjistratin Kledian Llaho, me detyrë Drejtues/prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, i cili përfundimisht kërkoi: Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit për dhënien e masës disiplinore.

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Pranë Këshillit është administruar shkresa nr.1942/25 prot., datë 10.12.2024 “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorit Kledian Llaho me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Kjo kërkesë është regjistruar me nr. 2292/6, datë 13.12.2024, në Këshill dhe shoqërohet nga Raporti i Hetimit disiplinor nr. 1942/22, datë 27.11.2024, si dhe akte, shkresa dhe dokumente të mbledhura gjatë hetimit disiplinor.
2. Hetimi disiplinor ndaj prokurorit Klodian Llaho ka nisur bazuar në ankesat e regjistruara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2987 prot., datë 28.06.2021 dhe nr. 2987/2 prot., datë 01.07.2021, të paraqitura nga shtetase Edja Seraj.
3. Pretendimet e ankueses ndaj prokurorit lidhen me zvarritjen e hetimit të procedimit penal, në funksion të kallëzimit që kjo shtetase ka bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ndaj firmës së ndërtimit “Konstruksion” Shpk, lidhur me objektin që kjo firmë është duke ndërtuar.

- 
4. Nga ana e prokurorit lidhur me këtë procedim penal të nisur, më datë 17.07.2018 është kërkuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pushimi i çështjes. Kjo kërkesë e prokurorit rezulton se nuk është pranuar nga gjykata e cila me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019, ka vendosur për kthimin e akteve duke lënë dhe detyra për kryerjen e veprimeve konkrete nga ana e prokurorisë. Ky vendim i gjykatës është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 269, datë 02.05.2019.
 5. Me vendimin. Nr. 3083/1 prot., datë 24.11.2023 Inspektori ka vendosur verifikimin e ankesës duke administruar akte dhe dokumentacion pjesë përbërëse e dosjes së këtij procedimi.
 6. Në themel të këtij procedimi qëndrojnë veprimet e prokurorit Kledian Llaho që lidhen me zvarritjen e hetimit të procedimit penal, në funksion të kallëzimit që ankuesja ka bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ndaj firmës së ndërtimit “Konstruksion” shpk, lidhur me objektin që kjo firmë është duke ndërtuar.
 7. Në përgjigje të kërkesës për informacion drejtuar Inspektorit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, fillimisht me shkresën nr. 12215/1 prot., datë 14.12.2023 ka dërguar informacion në të cilën shprehet mes të tjerave se: “Procedimi penal i mësipërm është regjistruar më datë 21.06.2018... në përfundim të hetimeve më datë 12.12.2018 është dërguar kërkesa për pushimin e gjykimit... Gjykata me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019 ka vendosur për kthimin e akteve prokurorit me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore sipas detyrave dhe urdhërimeve të lëna nga gjykata. është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë e cila pasi ka shqyrtuar çështjen me vendimin nr. 269, datë 02.05.2019 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 8. Nga Prokurori i çështjes në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata rezulton të jenë administruar akte nga procedime të tjera të cilat kanë lidhje me procedimin nr. 2167/2018, dhe në përfundim të hetimeve më datë 17.06.2021 çështja është dërguar përsëri me kërkesë për pushimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. ...”
 9. Nisur nga dokumentacioni i dërguar nga kjo prokurori, në kushtet kur ajo është shprehur në shkresë se, çështja është ridërguar përsëri në gjykatë më datë 17.06.2021 dhe se kjo e fundit ka vendosur përsëri mospranimin e kërkesës për pushimin e gjykimit të procedimit penal, nuk është përcjellë nga ana e saj asnjë dokumentacion lidhur me këto veprimeve/akte të kryera nga prokurorët në kuadër të zbatimit të vendimit të gjykatës nr. 184, datë 26.02.2019, për kryerje veprimesh hetimore të mëtejshme, është konsideruar i rëndësishëm nga Inspektori analizimi i veprimitarisë së prokurorit në raport me pretendimin e ngritur në këto ankesa, ri kërkimi i këtij informacioni. Është kërkuar ky informacion pranë prokurorisë, e cila me shkresën e saj nr. 227/1 prot., datë 18.01.2024 ka informuar se: “Nga prokurori i çështjes në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata rezulton të jenë administruar akte/vendime nga procedime të tjera të cilat kanë lidhje me procedimin nr. 2167/2018.

10. Në përfundim të hetimeve më datë 17.06.2021 bazuar sa më sipër, çështja është dërguar përsëri me kërkesë për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
11. Ndërkohë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në përgjigje të kërkesës për informacion ka dërguar shkresën nr. 1009/1 prot., datë 07.12.2023, me anë të cilës ka dërguar kopje të dosjes gjyqësore penale që i përket vendimit të saj penal nr. 184, datë 26.02.2019 dhe ankimi i prokurorisë ndaj vendimit të sipërcituar për kthimin e akteve, vendimin e gjykatës së Apelit Vlorë nr. 269, datë 02.05.2019. Gjithashtu edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me shkresën nr. 17200/1 prot., datë 08.01.2024, është shprehur se nga verifikimi që i ka bërë sistemit ICMIS rezulton e përfunduar çështja penale me palë kallëzues Edja Seraj me vendimin nr. 269, datë 02.05.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë.
12. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka përcjellë kopje të vendimit nr. 75, datë 21.04.2022, si dhe duke informuar se në zbatim të vendimit të saj nr. 184, datë 26.02.2019 është përcjellë me shkresën nr. 2239 prot., datë 07.06.2019 pranë prokurorisë fashikulli i dosjes së procedimit penal nr. 1167/2018, pjesë e të cilës është edhe kërkesa e parë e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Bashkëlidhur, gjithashtu, gjykata ka përcjellë edhe shkresën nr. 10397 prot., datë 28.10.2022, me anë të të cilës është përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë fashikulli i procedimit penal nr. 1167/2018 në zbatim të vendimit të gjykatës nr. 75, datë 21.04.2022.
13. Në vendimin nr. 75, datë 21.04.2022 gjykata ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë që i përkasin procedimit nr. 1167 të vitit 2018 për realizimin e veprimeve të mëtejshme hetimore nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në vlerësimin e saj gjykata është shprehur se: “Konstatohet se prokuroria është mjaftuar me administrimin e akteve të proceseve civile gjyqësore që kanë ekzistuar mes palëve kallëzuese dhe të kallëzuara, por ndërkohë nuk ka përmbushur as detyrat e përcaktuara me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që ka disponuar edhe më parë për kthimin e akteve prokurorisë. Rezulton se prokuroria nuk ka hetuar në lidhje me ekzistencën e dy lejeve zhvillimore me të njëjtat data, numër vendimi, nënshkrimi titullari lëshuar për të njëjtin subjekt ndërtues, por me parametra të ndryshëm teknik dhe kondicioneve urbanistike dhe më dy numra të ndryshëm protokollit”.
14. Në analizë të fakteve të konstatuara, sipas Inspektorit ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në provat e marra gjatë verifikimit të ankesës, se nga ana e prokurorit Kledian Llaho, si prokuror i çështjes deri më datë 26.01.2022, mund të jetë kryer shkelja disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” neni 102 i ligjit “Për statusin”, i cili parashikon shprehimisht se: “1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: a) ...; ç) mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit; (d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale; dh) veprimi, mosveprimi ose

sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin...[...]”.

15. Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 1942/1 prot., datë 10.07.2024, ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit Kledian Llaho për shkeljen disiplinore të parashikuar në pikën 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, neni 102 i ligjit “Për statusin” dhe në përfundim të hetimit disiplinor, Inspektori ka vendosur:
16. *Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit z. Kledian Llaho, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të ligjit “Për statusin”. Mbylljen e hetimit disiplinor ndaj magjistratit të evidentuar në pikën 1, të këtij propozimi, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit “Për statusin”.*
17. *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. Kledian Llaho, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit “Për statusin”. Propozimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c” dhe neni 108 i ligjit “Për statusin”, masën 40 % (përqind) të pagës për një afat njëvjeçar...”*
18. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Kledjan Llaho nëpërmjet paraqitjes në Këshill të kërkesës “Për fillim të procedimit disiplinor” të shoqëruar me Raportin Hetimor dhe dosjen e plotë të procedimit. për shkeljen disiplinore të parashikuar në pikën 1, shkronjat “ç”, “d”, neni 102 i Ligjit “Për statusin...”
19. Në funksion të këtij procedimi Këshilli ka zhvilluar procedurat disiplinore të parashikuara nga ligji dhe rregullorja e disiplinës si dhe ka thirrur palët në seancë dëgjimore të zhvilluar në datën 16.01.2025 ora 10.30 në sallën e mbledhjeve të këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ka vijuar me procedimin deri me datë 30.01.2025 ora 10.00 kur Këshilli ka vendosur dhe ka shpallur vendimin e tij në lidhje me këtë procedim disiplinor.

II. RAPORTI I HETIMIT DISIPLINOR DHE QËNDRIMI I ILD NË LIDHJE ME KËRKESËN

20. Sipas Inspektorit, në analizë të bazuar në dokumentacionin e administruar në kuadër të këtij procesi hetimor, rezultojnë të provuara faktet, si më poshtë:
21. Në kuadër të këtij procesi hetimi disiplinor konstatohet, se prokurori Kledian Llaho në kohën e shkeljes së pretenduar ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila pas riorganizimit të emërtohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Në kuadër të ushtrimit të këtij funksioni, rezultojnë të provuara faktet të trajtuara më poshtë.

22. Lidhur me këtë hetim disiplinor rezulton, se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është regjistruar materiali i kallëzuar nr.1167/2018, bazuar në kallëzimin (bërë nëpërmjet shërbimit postar) e shtetases Edja Seraj. Me shortin e datës 20.06.2018, çështja i ka kaluar për ndjekje prokurorit Kledian Llaho. Më datë 21.06.2018, prokurori i çështjes ka nxjerrë Urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprat penale *“Falsifikim i dokumenteve”* dhe *“Ndërtim i paligjshëm”* parashikuar nga neni 199/a dhe neni 186 i Kodit Penal, si dhe caktoi oficerin e policisë gjyqësore Ylber Zogaj në këtë hetim. Në arsyetimin e këtij urdhri, prokurori është shprehur ndër të tjera, se: bazuar në materialin e kallëzues ka konstatuar se nga ana e kësaj shtetaseje janë kallëzuar faktet:
23. “Subjekti “Konstruksion” Sh.P.K, me përfaqësues ligjor A. P., po ndërton një objekt në Radhimë të qytetit të Vlorës, objekt i cili ndodhet në kufi me pronën e kallëzueses. Për ndërtimin e atij objekti rezulton të jetë miratuar leje ndërtimi me nr.7, datë 23.07.2013 me numër protokollit “nr. 28” dhe me kondicionet përkatëse të pasqyruara në leje. Kallëzuesja pretendon se nëse do të ishte zbatuar drejt leja e ndërtimit në fjalë, ajo nuk do të kishte ndonjë konflikt me zhvillimin e objektit. Kallëzuesja ka parashtruar faktin se përfaqësuesit e subjektit kanë përpiluar një dokument tjetër “leje ndërtimi: duke e zhvilluar objektin më shumë nga sa është miratuar me lejen e ndërtimit nr.7, datë 23.07.2013 me nr. 28 prot.
24. Ky dokument, pra leje ndërtimi nr.7, datë 23.07.2013 me nr.28 prot., vërtetohet si autentik dhe origjinal, edhe nga fakti se Bashkia Vlorë më datë 30.05.2018, me Vendimin nr. 852, datë 30.05.2018 ka vendosur të pranojë shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit me nr.38 prot., datë 07.07.2015 në pronësi të A. Selmanaj. Kjo shtyrje e afatit të lejes është bazuar në lejen zhvillimore me nr. 28 prot., datë 23.07.2013, dokument i cili është dorëzuar nga vetë subjekti në gjykatë. Pra, kjo leje, pretendon kallëzuesja, vërteton faktin se subjekti e ka të falsifikuar lejen tjetër me nr. 29 prot., datë 23.07.2013 që përdor në terren gjatë ndërtimit. Dyshimet e saj kallëzuesja i referon edhe nga dy shkresat e dala nga IKMT dhe Gjykata, të cilat disponojnë të njëjtin dokument “leje ndërtimi” nr.28, datë 23.07.2013. Nga aktet e depozituara nga kallëzuesja rezulton se dokumenti leje ndërtimore nr.29 prot., datë 23.07.2013, pasqyron kondicione të ndryshme nga dokumenti leje ndërtimi nr. 28 prot., datë 23.07.2013. Kallëzuesja ka administruar dokumente edhe nga RIT (Regjistri i Integruar i Territorit), sipas të cilave rezulton se leja zhvillimore nr.7, datë 23.07.2013 nuk pasqyrohet e regjistruar në regjistrin kombëtar RIT Tiranë, e për pasojë nga pikëpamja formale dokumenti nuk i ka prodhuar efektet juridike. ...”.
25. Pas nxjerrjes së Urdhrit të datës 21.06.2018, rezulton se më datë 10.09.2018 prokurori i çështjes Kledian Llaho ka nxjerrë Urdhrin *“Për kryerjen e veprimeve hetimore”*. Në këtë urdhër prokurori, pasi ka evidentuar edhe njëherë faktet e kallëzimit penal të depozituara nga shtetasja Edja Seraj, të evidentuar edhe në urdhrin e datës 21.06.2018, ka përcaktuar kryerjen e *“veprime të mëtejshme hetimore”*, për kryerjen e të cilave ka ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore Ylber Zogaj, si dhe ka përcaktuar afatin, datë 30.11.2018, brenda të cilave të kryhen ato. Me shkresën nr. 9508 prot., datë 26.09.2018 i janë kërkuar të dhëna

Njesisë Administrative Orikum, e cila me shkresën nr. 515/1 prot., datë 05.10.2018 ka kthyer përgjigje.

26. Më datë 03.10.2018 janë marrë të dhëna nga oficeri i policisë gjyqësore, për rrethanat e kryerjes së veprës penale, nga shtetasi Gj. P., të dhëna të marra të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e kësaj date.
27. Më datë 31.10.2018 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur bashkimin e dy procedimeve penale në një procedim të vetëm. Konkretisht janë bashkuar procedimi penal nr.1979 i vitit 2018 që hetohet nga prokurorja Elona Alvora regjistruar për nenin 248 të Kodit Penal, me procedimin penal nr.1167 të vitit 2018. Me hetimin e këtij procedimi është ngarkuar prokurori Kledian Llaho.
28. Më datë 20.11.2018 oficeri i policisë gjyqësore ka përpiluar *“Relacion për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr.1167, të vitit 2018”* drejtuar prokurorit të çështjes Kledian Llaho. Në përfundim të këtij relacioni, oficeri i policisë gjyqësore ka sugjeruar që *“çështja të pushohet në kushtet e nenit 328/1, germa “F” të Kodit të Procedurës Penale, në zbatim të parimit gjë e gjykuar”*.
29. Më datë 12.12.2018 prokurori i çështjes i është drejtuar me shkresën nr.13082 prot., Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr.1167 të vitit 2018, procedim i regjistruar për veprat penale *“Falsifikim i dokumenteve”* dhe *“Ndërtim i paligjshëm”*, parashikuar përkatësisht nga nenet 186 dhe 199/a të Kodit Penal. Në këtë shkresë prokurori ka arsyetuar në përfundim se: *“Si përfundim, duke analizuar hollësisht rrethanat dhe faktet e provuara si më sipër, kjo çështje penale duhet të pushohet, pasi ekziston një fakt për të cilin ndjekja nuk mund të vazhdojë, që është pikërisht fakti i hetimit të mëparshëm për të njëjtin fakt nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë”*. Me shkresën nr. 13082/1 prot., (K. Ll.) datë 21.12.2018 i është dërguar për njohje, kallëzueses shtetases Edja Seraj, kërkesa për pushimin e çështjes në kuadër të procedimit penal nr. 1167 të vitit 2018.
30. Kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal të regjistruar me nr.1167 të vitit 2018, është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me nr.2239 akti, datë 24.12.2018. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, Gjykata me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019, ka vendosur mes të tjerave:
31. *“Kthimin e akteve prokurorit me qëllim që të kryhen veprimet hetimore lidhur me procedimin penal nr. 1167/2018 në këto drejtime: i) të përcaktohet grup ekspertësh për të përcaktuar nëse vendimi nr. 21, datë 01.07.2013 protokolluar më datë 29, është apo jo në përputhje me “Rregullore për Zbatimin e Studimit Urbanistik të Zonës me Përparësi Turistike Radhimë - Orikum për zonën A1 0-a/1 (miratuar me vendimin nr.12, datë 14.07.2009)” dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.07.2011 “Për*

miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit”. ii) të hetohet nëse ekziston vendimi nr.21, datë 01.07.2013, prot., datë 28, nëse jo, të hetohet nëse është i falsifikuar si dhe kujt i atribuohet fakti penal.

32. Veprimet hetimore të kryhen brenda 3 (tre) muajve”. Në vendimin nr.184, datë 26.02.2019, gjykata ka arsyetuar se: *“Nga aktet e grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak rezultoi, se ka dy leje zhvillimore të lëshuara për subjektin “Konstruksion” SHPK, të cilat kanë të njëjtën datë, numër vendimi, nënshkrimin e titullarit, vulën dhe ndryshojnë vetëm përsa i përket numrit të protokollit si dhe kondicioneve urbanistike. Në këto kushte, është e domosdoshme të hetohet nëse leja zhvillimore nr. 28 prot., datë 23.07.2013 ekziston dhe nëse është lëshuar ndonjëherë nga autoriteti kompetent. Gjykata vlerëson se, nëse konkludohet se leja nuk ekziston duhet të deklarohet falsiteti i saj si dhe të hetohet në lidhje me personin të cilit i atribuohet fakti penal (nëse rezulton e tillë).*
33. *Gjithashtu rezulton se, në kuadër të procedimit penal nr. 2520/2016 është administruar i protokolluar me nr. 3934, datë 23.05.2017, nga ku ka rezultuar se: Kondicionet teknike të miratuara me lejen zhvillimore nr. 7, datë 23.07.2013 (miratuar me vendimin nr. 21, datë 01.07.2017, të Kryetarit të Bashkisë), janë në kundërshtim me “Rregulloren për Zbatimin e Studimit Urbanistik të Zonës me Përparësi Turistike Radhimë-Orikum, për zonën A1 0-a/1 (miratuar me vendimin nr. 12, datë 14.07.2009) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullave uniformë të kontrollit të zhvillimit”. Kështu ka të dhëna se leja zhvillimore objekt kallëzimi penal është marrë në kundërshtim me aktet nënligjore. Për këtë arsye është e domosdoshme që nga ana e prokurorit të caktohet një grup ekspertësh të cilët përcaktojnë nëse leja zhvillimore e datës 23.07.2013 (nr. 29 prot.) është apo jo në përputhje me “Rregulloren për Zbatimin e Studimit Urbanistik të Zonës me Përparësi Turistike Radhimë-Orikum, për zonën A1 0-a/1 (miratuar me vendimin nr. 12, datë 14.07.2009) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullave uniformë të kontrollit të zhvillimit”.*
34. Ndaj vendimit të gjykatës nr. 184, datë 26.02.2019, prokurori ka ushtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes nr. 1167/2018 bazuar në nenin 328.1, shkronja “dh” dhe nenin 329/b, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale. Në ankimin e bërë është theksuar se *“... vendimi i gjykatës është marrë duke vlerësuar gabimisht rrethanat e faktit dhe duke interpretuar gabim ligjin penalo-procedural dhe si i tillë duhet të ndryshohet duke vendosur për pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale nr. 1167/2018”.*
35. Në arritjen e këtij qëndrimi prokurori në ankimin e bërë ka evidentuar faktin se pranë kësaj prokurorie është regjistruar më herët procedimi penal nr.567/2017 për veprat penale *“Falsifikimi i dokumenteve”* dhe *“Shpërdorim i detyrës”* parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Edhe ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të depozituara nga shtetasja Edja Seraj, e cila ka pretenduar se në pronën e saj tokë truall me

sipërfaqe 545 m², ndodhur në fshatin Radhimë, ku janë duke u ndërtuar dy objekte banimi nga ana e shoqërisë “Konstruksion” SHPK, me administrator shtetasin Gj. P.

36. Në përfundim të këtyre hetimeve më datë 17.07.2018 prokurori i çështjes ka marrë vendim për pushimin e procedimit penal 567/2017, duke arsyetuar se nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar “... që nga ana e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “Konstruksion” SHPK, apo ndonjë person tjetër, të jenë kryer veprime aktive me qëllim paraqitjen e rrethanave të rreme nëpërmjet ndërhyrjes në një dokument të caktuar. Nga hetimet e kryera rezultoi e provuar se nuk ekziston leje ndërtimore zhvillimore me nr. 28 prot., datë 23.07.2013, sikurse është pretenduar nga kallëzuesja Edja Seraj, por leja e ndërtimit mbi bazën e të cilës është kryer ndërtimi nga ana e shoqërisë “Konstruksion” SHPK, është ajo me nr. 29 prot., datë 23.07.2013. Gjatë hetimeve u konstatua se ky dokument, është lëshuar realisht nga ana e Bashkisë Oriku në favor të subjektit “Konstruksion” SHPK, për shkak se një fakt i tillë rezultoi gjatë këqyrjes së librit të protokollit të mbledhjeve të KRRT-së Bashkia Oriku. ...”.
37. Gjithashtu, në ankimin ndaj Vendimit nr.184, datë 26.02.2019 prokuroria ka evidentuar faktin se ka edhe një vendim tjetër pushimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht vendim pushimi i çështjes penale nr. 2520/2016, vendim i cili, sipas prokurorit, ka “trajtuar gjerësisht pretendimet e shtetasës Edja Seraj, në lidhje me veprën penale “Ekspertim i rremë” dhe “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga nenet 309 dhe 199/a të Kodit Penal”. Ndaj dhe sipas prokurorit rezulton se kemi të bëjmë me të njëjtin fakt të regjistruar edhe më parë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për të cilin me vendim të prokurorit është vendosur pushimi i procedimit penal bazuar në nenin 328.1, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale.
38. Ankimi i prokurorit të çështjes ndaj vendimit të gjykatës nr. 184, datë 26.02.2019, është regjistruar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, me nr. 365 Regj., datë 18.04.2019. Kjo gjykatë me vendimin nr. 269 datë 02.05.2019 ka vlerësuar të pabazuar ankimin e prokurorit dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr,184 datë 26.2.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
39. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit, ka arsyetuar ndër të tjera, se: *“Në këto kushte, është e domosdoshme të hetohet nëse leja zhvillimore nr.28 prot., datë 23.07.2013 ekziston dhe nëse është lëshuar ndonjëherë nga autoriteti kompetent. Nëse konkludohet se leja nuk ekziston, duhet të deklarohet falsiteti i saj, si dhe të hetohet në lidhje me personin të cilit i atribuohet fakti penal. Gjithashtu, rezulton se në kuadër të procedimit penal është administruar i protokolluar me nr.3934, datë 23.05.2017, nga ku ka rezultuar ... Për këtë arsye është e domosdoshme që nga ana e prokurorit të caktohet një grup ekspertësh të cilët përcaktojnë nëse leja zhvillimore e datës 23.07.2013 (nr. 29 prot.) është apo jo në përputhje me “Rregulloren për Zbatimin e Studimit Urbanistik të Zonës me Përparësi Turistike Radhimë-Oriku, për zonën A1 0-a/1 (miratuar me vendimin nr. 12, datë*

SEKRE

14.07.2009) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.07.2011 "Për miratimin e rregullave uniforme të kontrollit të zhvillimit".

40. Me shkresën nr. 2239 akti, datë 07.06.2019 Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka përcjellë aktet e procedimit penal nr.1167 të vitit 2018. Konstatohet se më datë 10.06.2021 oficeri i policisë gjyqësore pranë kësaj prokurorie, ka mbajtur procesverbal "Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve" pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për marrjen vendimit të kësaj gjykate, nr. 319, datë 18.04.2018. Më datë 17.06.2021 prokurori Kledian Llaho i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, bazuar në nenet 328/1, shkronja "b" dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale, me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr.1167 të vitit 2018 regjistruar për veprat penale të parashikuara nga neni 186 dhe neni 199/a të Kodit Penal. Në këtë vendim të prokurorit për pushimin e procedimit penal është arsyetuar se:
41. "Në lidhje me urdhërimet e gjykatës, organi i procedimit vlerëson se të dyja ato janë ezauruar, si nga veprimet hetimore të kryera në funksion të disa çështjeve penale, ashtu edhe nga veprimet dhe administrimi i provave në funksion të çështjes civile me objekt: pushim i cenimit në pronësi dhe kallëzimi i një punimi të ri me palë paditëse: Edja Seraj dhe palët e paditur subjekti "Konstruksion" Sh.P.K, me përfaqësues ligjor A. P. Në lidhje me disponimin e parë, organi i procedimit vlerëson se kryerja e një akti tjetër ekspertimi është e panevojshme madje e tepërt duke qenë se çështjet e ngritura kanë gjetur zgjidhje nga aktet e ekspertimit të zhvilluara në funksion të çështjes civile. ... Në lidhje me disponimin e dytë të vendimit nr. 184, datë 26.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, organi i procedimit vlerëson se ajo është ezauruar në kuadër të veprimeve për procedimin penal nr.576 vitit 2017 dhe i është parashtruar gjykatës edhe në kërkesën e parë për pushimin e kësaj çështjeje penale. ...".
42. Kërkesa e prokurorit për pushimin e gjykimit të çështjes penale, bazohet kryesisht, në provat dhe dokumentacionin e administruar në gjykimin e çështjes civile, ngritur nga paditësja (ankuesja Edja Seraj) ndaj të njëjtës kompani për të cilën ka bërë dhe kallëzimin penal, konstatohet se kjo çështje civile ka përfunduar me vendimin nr.1303, datë 18.04.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë nr. 22, datë 14.02.2017, e cila ka rrëzuar padinë e kësaj shtetaseje (Edja Seraj). Në kuadër të këtij gjykimi është kryer edhe një akt ekspertimi me ekspertë të fushës ndaj dhe prokurori nisur nga ky fakt ka vlerësuar në kërkesën për pushimin e gjykimit të çështjes penale, se kryerja e një akti ekspertimi është e panevojshme madje e tepërt duke qenë se çështjet e ngritura kanë gjetur zgjidhje nga aktet e ekspertimit të zhvilluara në funksion të çështjes civile.
43. Kërkesa e dytë e prokurorit të çështjes e datës 17.06.2021, për pushimin e procedimit penal nr. 1167 të vitit 2018, është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. 1598. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, gjykata me Vendimin nr.75, datë 21.04.2022, ka vendosur përsëri, për kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor

4-SEK

Vlorë që i përkasin procedimit penal nr.1167, të vitit 2018 për realizimin e veprimeve të mëtejshme hetimore nga ana e saj. Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar ndër të tjera se:

44. “Në vlerësimin e gjykatës, nuk janë bërë verifikime të plota në këtë procedim dhe as vlerësim i plotë i rrethanave të faktit, kur ndërkohë faktet e kallëzuara kanë mbetur ende të pasqaruara dhe të pazbardhura. Konstatohet se prokuroria është mjaftuar me administrimin e akteve të proceseve civile gjyqësore që kanë ekzistuar mes palëve kallëzuese dhe të kallëzuara, por ndërkohë nuk ka përmbushur as detyrat e përcaktuara me vendimin nr.184, datë 26.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që ka disponuar edhe më parë për kthimin e akteve prokurorisë.
45. Rezulton se prokuroria nuk ka hetuar në lidhje me ekzistencën e dy lejeve zhvillimore me të njëjtat data, numër vendimi, nënshkrimi titullari, lëshuar për të njëjtin subjekt ndërtues, por me parametra të ndryshëm teknik dhe kondicioneve urbanistike dhe me dy numra të ndryshëm protokollit, konkretisht leja zhvillimore me nr. 28 dhe nr. 29, të lëshuara nga Bashkia Orikum. Rezulton se kallëzueses, leja zhvillimore me nr. 28 prot., datë 03.07.2013, nr. 21 vendimi, datë 01.07.2013 Bashkia Orikum, i është njoftuar me shkresën nr.176 prot., datë 22.11.2016 të IKMT dhe shkresën nr. 4584 prot., datë 07.10.2015. Pra dyshimi i kallëzueses rezulton të ketë baza objektive.
46. Në vlerësimin e Gjykatës është evidente dhe e dukshme se nga ana e prokurorisë nuk është hetuar në cilat rrethana apo për cilat shkaqe ligjore apo të ligjshme ekzistojnë në fakt dy leje zhvillimore të lëshuara nga institucionet shtetërore për të njëjtin objekt, pse janë lëshuar këto akte nga Bashkia Orikum dhe si shpjegohet se administrohet nga Bashkia Orikum vetëm leja me nr. 29 prot., datë 23.07.2013 kur ndërkohë rezulton nga aktet që kallëzuesja ka vendosur në dispozicion se IKMT i ka njoftuar me shkresë lejen zhvillimore nr. 7, datë 23.07.2013 me nr. 28 prot., datë 23.03.2017 të Bashkisë Orikum nr. 21 vendimi, datë 01.07.2013 të Kryetarit të Bashkisë.
47. Ka vend për dyshim të arsyeshëm si për veprën penale të falsifikimit të dokumentit, sipas nenit 186/3 të Kodit Penal nga subjekti që ka për detyrë lëshimin e dokumentit pasi njëra nga lejet duhet të jetë e falsifikuar për sa të dy lejet nuk mund të ekzistojnë njëkohësisht, ashtu dhe dyshimi të arsyeshëm për fakt penal zhdukje të dokumentit bazuar në nenin 192/a të Kodit Penal së rast se pas verifikimit hetimor do të rezultojë se leja nr. 28 prot., datë 23.07.2013 nuk gjendet....”.
48. Në vijim të arsyetimit gjykata në vendimin nr.75, datë 21.04.2022, shprehet se prokuroria duhet të administronte në origjinal shkresat me nr. 4584 prot., datë 07.10.2015, nr. 1786 prot., datë 22.10.2016, duhet të bënte verifikime në librin e protokollit pranë Bashkisë Orikum, të pyeteshin punonjësit e kësaj bashkie, të hetonte mbi procedurën e mbledhjes së zhvilluar nga Bashkia Orikum për lëshimin e lejes nr. 28 prot., dhe nr.29 prot., datë 23.07.2013 dhe në varësi të rezultateve të verifikimeve të vlerësonte nëse ka vend për

4 - SEKRE

përsëritjen e ekspertimit inxhiniero-teknik dhe topografik me grup ekspertësh për të parë raportin mes ndërtimit në fakt në terren, parametrave të përcaktuara në lejen e vërtetë zhvillimore dhe akteve nënligjore, apo në ka qenë i drejtë përfundimi i arritur në ekspertimin e realizuar në kuadër të procesit gjyqësor civil të përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse leja me nr.29 prot., datë 23.07.2013 do të rezultojë e vërtetë dhe e vlefshme ligjërisht.

49. Rezulton se prokurori nën hetim disiplinor Kledian Llaho, ndërsa ka paraqitur kërkesën e dytë për pushimin e procedimit penal më datë 17.06.2021, me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr.5, datë 14.01.2022, është transferuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ndaj në këto kushte, në vend të tij, procedimi penal nr. 1167 i vitit 2018, për të cilin ai ka depozituar kërkesën e pushimit të tij, i ka kaluar në ngarkim një prokuroreje tjetër të institucionit dhe konkretisht, prokurores Flora Çela.
50. Në vendimin e gjykatës nr.75, datë 21.04.2022 nuk rezulton se kjo prokurore ka marrë pjesë, pasi ky vendim është shpallur në mungesë të saj. Në vijim ky procedim penal, për shkak se ka qenë e regjistruar edhe me nenin 186 të Kodit Penal, është përfshirë në seksionin e hetimit të krimit ekonomik pastrimit të parave financimit të terrorizimit dhe hetimit pasuror, dhe nga rishortimi i saj 02.11.2022 ajo i ka kaluar prokurorit Arian Xhaferraj, i cili më datë 28.06.2024 ka dorëzuar deklaratë për heqje dorë, me motivacionin se është shprehur më parë me vendim pushimin e çështjes penale.

II. PARASHTRIMET E MAGJISTRATIT KLEDIAN LLAHO, INSPEKTORIT, QËNDRIMI DHE PROVAT E PARAQITURA PARA KËSHILLIT

51. Seanca dëgjimore për procedimin disiplinor në ngarkim të prokurorit Kledian Llaho u zhvillua në praninë e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), përfaqësueses së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), dhe magjistratit subjekt procedimi disiplinor. Gjatë seancës, u paraqitën parashtrësit e palëve dhe u zhvilluan pyetje nga anëtarët e KLP-së lidhur me bazën faktike dhe juridike të procedimit.
52. Përfaqësuesja e ILD-së argumentoi se procedimi ishte nisur për shkak të moszbatimit të detyrave të lëna nga gjykata dhe vonesave të pajustificuara nga ana e magjistratit. Ajo theksoi rëndësinë e respektimit të detyrimeve ligjore për të garantuar besimin publik në sistemin e drejtësisë.
53. Magjistrati Llaho mbrojti veprimet e tij duke deklaruar se kishte përmbushur detyrat sipas ligjit dhe vonesat ishin shkaktuar nga faktorë objektivë, si ngarkesa e punës situata e pandemisë dhe mungesa e burimeve.

54. KLP pyeti përfaqësuesin e ILD-së, për arsyet e vonesës në nisjen e hetimit disiplinor dhe konceptin e “pasojave të rënda” që cenojnë besimin publik.
55. Përfaqësuesja e ILD-së sqaroi se vonesat ishin për shkak të kapaciteteve të kufizuara të institucionit dhe se shkeljet e magjistratit kishin krijuar një precedent negativ dhe cenonin integritetin e institucionit dhe besimin e publikut.
56. Subjekti i procedimit u pyet mbi zbatimin e detyrave të lëna nga gjykata, përfshirë verifikimin e lejeve zhvillimore dhe caktimin e ekspertëve. Magjistrati argumentoi se kishte ndjekur procedurat dhe se kishte administruar provat e nevojshme.
57. Në përgjigjet e tij, prokurori theksoi se disa nga detyrat e lëna nga Gjykata ishin ezauruar në hetime të mëparshme dhe se vendimet e tij ishin të bazuara në prova ekzistuese dhe në Kodin e Procedurës Penale.
58. Magjistrati kundërshtoi këtë argument, duke pohuar se qasja e tij ishte në përputhje me ligjin dhe se veprimet e tij kishin qenë të arsyeshme.

IV. VEPRIMET PROCEDURALE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

59. Këshilli dhe Komisioni Disiplinor ka kryer veprimet procedurale në lidhje me kërkesën e ardhur nga Inspektori për marrjen e masës disiplinore “Propozimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c” dhe neni 108 i ligjit “Për statusin”, në masën 40 % (përqind) të pagës për një afat 1 (një)-vjeçar, ndaj prokurorit Klodian Llaho, si më poshtë:
- i. Në datë 17.12.2024, ora 13.30, Komisioni Disiplinor ka zhvilluar *on-line* në platformën *Zoom* mbledhjen për hedhjen e shortit për caktimin e Relatorit.
 - ii. Po në datë 17.12.2024, Komisioni Disiplinor ka miratuar Relacionin “*Për caktimin e datës së seancës dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit Klodian Llaho*”, të shoqëruar nga projektvendimi përkatës. Komisioni Disiplinor ka propozuar që seanca dëgjimore për prokurorin Klodian Llaho të zhvillohet në dt. 10.01.2025, ora 10.30, në përputhje me nenin 138, pika 3, të Ligjit për Statusin.
 - iii. Propozimi i Komisionit Disiplinor për zhvillimin e seancës dëgjimore në dt. 10.01.2025, ora 10.30 është miratuar me Vendimin nr.268, datë 23.12.2024 “Për caktimin e seancës dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit Klodian Llaho”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
 - iv. Me Shkresën nr. 2292/9 prot., datë 24.12.2024 “*Njoftim Vendimi nr. 268, datë 23.12.2024, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë*”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori Klodian

- Llaho dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë janë njoftuar për datën e seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 141, të Ligjit për Statusin.
- v. Me Shkresën nr.2292/10, datë 24.12.2024 “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor dhe njohje me të drejtat”, prokurori Klodian Llaho është njohur me fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij, si dhe me të drejtat e tij në këtë proces, në përputhje me nenin 141, pika 2, të Ligjit për Statusin. Njëkohësisht, ai është njoftuar lidhur me të drejtën për të paraqitur parashtrës, me shkrim, para Këshillit, të paktën 1 (një) javë përpara datës së seancës dëgjimore.
- vi. Në mbledhjen e Komisionit Disiplinor të zhvilluar në zyrën e Kryetarit të Komisionit Disiplinor më datë 27.12.2024, ora 12.46, në platformën on-line Zoom, në lidhje me diskutimin e Relacionit Paraprak për këtë procedim Disiplinor në ngarkim të prokurorit Klodian Llaho, u la detyrë nga Relatori dhe Anëtarët e Komisionit, që të kërkohej informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në lidhje me fatin e Kallëzimit Penal nr.1167/2018, mbi të cilin Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka disponuar me Vendimin Nr.75, datë 21.04.2022 (Vendim i formës së prerë), duke vendosur kthimin e akteve për veprime të mëtejshme pranë Prokurorisë Vlorë.
- vii. Menjëherë Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë ka kthyer përgjigje në adresën zyrtare elektronike të Komisionit Disiplinor disiplina@klp.al, i cili ka konfirmuar, se: ”Procedimi nr. 1167/2018, i prokurorit Klodian Llaho është akoma në fazën e hetimit paraprak. Pas transferimit të prokurorit Klodian Llaho, ky procedim penal i ka kaluar me short prokurorit Arian Xhaferraj, i cili e ka patur në hetim deri në datën 24.07.2024, kur ka hequr dorë nga hetimi i këtij procedimi penal. Aktualisht, ky procedim penal po hetohet nga prokurori Mirjon Brahimllari”.
- viii. Më datë 30.12.2024, ora 11:36 min, nga adresa elektronike e Komisionit ju është shpërndarë të gjithë Anëtarëve të Këshillit Relacioni Paraprak për këtë procedim Disiplinor, në ngarkim të prokurorit Klodian Llaho.
- ix. Po më datë 30.12.2024, në adresën elektronike info@klp.al të Këshillit, magjistrati ka kërkuar kopje të Dosjes hetimore të ardhur në Këshill nga ILD, e cila iu vu në dispozicion nga Këshilltarët e Komisionit.
- x. Prokurori Klodian Llaho ka dërguar me e-mail në adresën elektronike të Komisionit disiplina@klp.al parashtrësat, me shkrim, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë më datë 06.01.2025, ora 14:03.
- xi. Më datë 08.12.2025 magjistrati Klodian Llaho ka dërguar përsëri në adresën elektronike të Komisionit kërkesë për të dhëna dhe, nga ana e Komisionit, i është dhënë përgjigje me shkrim, me shkresën nr.1860/15 prot., datë 09.01.2025, se: “Nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ju është vënë në dispozicion, konform ligjit, dosja e plotë hetimore që shoqëron
- xii. kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor Nr.1942/25 prot., datë 10.12.2024. Pavarësisht sa më sipër, rezervoni të drejtën që çdo kërkesë që mund të kenë në lidhje me procedimin disiplinor në ngarkimin tuaj, mund ta parashtroni në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohet ditën e nesërme, më datë 10.01.2025, ora 10.30”

- DEK
- i. Me datë 10.01.2025 ora 10.30 ashtu siç ishte paracaktuar, u zhvillua Seanca Dëgjimore në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit, me praninë e të gjithë anëtarëve dhe të dy palëve në proces disiplinor.
 - ii. Në fund të seancës Këshilli i la detyrë dy palëve në proces që të dorëzonin Konkluzionet Përfundimtarë me shkrim më datë 16.01.2025 ora 10.00.
 - iii. Po me datë 16.01.2025 ora 10.00 në mbledhjen e radhës të Këshillit u paraqitën palët në proces disiplinor të cilët paraqitën Konkluzionet e tyre me shkrim.
 - iv. Me datë 20.01.2025 ora 11.00, me kërkesë të Kryetarit dhe të Relatorit të çështjes u mblodh Komisioni Disiplinor për të diskutuar dhe miratuar Relacionin Përfundimtar të këtij procesi disiplinor. Kjo bazuar në nenin 36 të Rregullores së Komisionit Disiplinor.
 - v. Me datë 23.01.2025 në adresë të gjithë anëtarëve të Këshillit i është shpërndarë për njohje Relacioni Përfundimtar bashkë me propozimin për masë disiplinore ndaj prokurorit Kledian Llaho përgatitur nga Relatori dhe Komisioni Disiplinor, brenda afati të parashikuar në nenin 36 të Rregullores së Komisionit Disiplinor, brenda 7 ditëve nga data 30.01.2025 kur Këshilli do të vendosë dhe do të shpallë Vendimin për këtë procedim disiplinor.
 - vi. Me datë 30.01.2025 ora 10.00 ashtu siç ishte paracaktuar u mblodhe Këshilli në seancë Plenare me praninë e të gjithë anëtarëve për të vendosur dhe shpallur vendimin e tij për procedimin disiplinor në fjalë. Ishin të pranishëm përfaqësuesja me Autorizim e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Prokurori nën procedim disiplinor nuk ishte i pranishëm në shpalljen e vendimit edhe pse kishte dijeni.

V. VLERËSIMET DHE KONKLuzionET E KËSHILLIT

60. Lidhur me ekzistencën e shkeljes disiplinore të pretenduar, rezulton se shkelja e pretenduar është brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore dhe si pasojë çështja nuk rezulton të jetë parashkruar, pasi i referohet veprimtarisë së prokurorit në procedimin penal nr. 1167/2018 regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë më datë 21.06.2018, veprimtari e cila ka vijuar deri në momentin kur është bërë kërkesa e tij pranë gjykatës respektive, datë 17.06.2021, për pushimin e procedimit penal. Ndaj shkelja e pretenduar, referuar nenit 117 të ligjit “Për statusin” nuk konsiderohet e parashkruar.
61. Prokurori subjekt hetimi disiplinor, Kledian Llaho ka ushtruar detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur. Aktualisht është transferuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
62. Në mbështetje të parashikimeve të neneve 3, 4, 101, 102, pika 1, shkronja “d”, 105, 115 të ligjit “Për statusin”, me qëllim identifikimin e elementeve juridikë dhe faktikë mbi

4-ŠEKRL

përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt i procedimit disiplinor, janë analizuar këto çështjet nëse:

63. veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale;
-kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore;
-llojin e masës disiplinore.
64. Në analizë të çështjes se nëse nga ana e magjistratit, subjekt procedimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale, vlen të theksohet, se në mbështetje të nenit 101, pika 2 të ligjit “Për statusin”, kur përcaktohet nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është i lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, janë marrë parasysh një sërë faktorësh si: (a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); (b) shpeshhtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; (c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; (ç) dëmtimi, mundësia e shkakimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe (d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.
65. Nga provat e administruara gjatë procedimit disiplinor, rezulton se ushtrimi i funksioneve të prokurorit në lidhje me hetimin e procedimit penal iniciuar nga kallëzimi i ankueses, sikurse aktet dhe veprimet procedurale që ai ka kryer, janë të natyrës që nëse provohen se ekzistojnë, përbëjnë shkelje disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 102, pika 1, shkronjat “ç”, “d” të ligjit “Për statusin”.
66. Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit të grumbulluar, rezulton se, ndërsa materiali kallëzues nr.1167/2018, i ka kaluar në ngarkim prokurorit më datë 20.06.2018, bazuar në kallëzimin e shtetases Edja Seraj, të nesërmen e kësaj date, më 21.06.2018, ai ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a dhe neni 186 i Kodit Penal, pa autor. Neni 287, pika 1 i Kodit të Procedurës Penale “Regjistrimi i njoftimit të veprave penale” përcakton se: “1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale”.
67. Në këto kushte ka rezultuar se, lidhur me procedimin penal nr. 1167/2018, në nisje të hetimeve, gjatë apo në përfundim të tij, nga ana e prokurorit të çështjes nuk është konkluduar në emrin e një personi që i atribuohet vepra penale, fakt i cili do të sillte regjistrimin e një procedimi me emër personi dhe për rrjedhojë respektimin e afateve të ndjekjes penale referuar nenit 323, të Kodit të Procedurës Penale.

68. Njëkohësisht, në këtë urdhër, prokurori ndërsa ka caktuar oficerin e policisë gjyqësore që ngarkohet me këtë hetim nuk ka përcaktuar detyrat që duhet të kryhen lidhur me të, veprim të cilin e bën pas dy muajve, më datë 10.09.2018, ku ka përcaktuar detyrat përkatëse që duhet të kryhen nga ana e oficerit të policisë gjyqësore. Pas përfundimit të hetimit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore dhe relatimit të veprimeve të kryera nga ana e tij pranë prokurorit përgjegjës, ky i fundit i përcjell më datë 12.12.2018 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. 1167 të vitin 2018.
69. Pra, në tërësi këto veprime të prokurorit, nga momenti i marrjes në ngarkim të dosjes, më datë 21.06.2018, janë kryer brenda një afati të arsyeshëm dhe objektiv, duke e përfunduar hetimin brenda një afati 6 mujor, që mund të konsiderohet afat optimal.
70. Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019, ka vendosur për kthimin e akteve prokurorit me qëllim të kryhen veprime hetimore lidhur me këtë procedim penal duke përcaktuar dhe dy detyra konkrete të cilat duhet të kryhen brenda një afati 3 mujor, rezulton se, nga ana e prokurorit të çështjes nuk janë përmbushur këto vendime. Arrihet në këtë konkluzion duke pasur në konsideratë rolin që ka gjyqtari i seancës paraprake në këtë proces, me një rol e rëndësi të veçantë për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve që kryhen nga prokurori, me një rol garantues të të drejtave të përcaktuara në ligj për palët.
71. Është gjyqtari i seancës paraprake që “vendos” në fazën e hetimeve paraprake, lidhur me çështjen, bazuar kjo në nenin 329/a, të Kodit të Procedurës Penale, i ndërlidhur ky përcaktim me parashikimet e nenit 332/ç të Kodit të Procedurës Penale, del dukshëm obligimi që ka prokurori për kryerjen e detyrave të lëna nga gjykata në rastet kur është kthimi i akteve prokurorit dhe vazhdimi i hetimeve, kur gjykata çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë.
72. Dispozita e Kodit të Procedurës Penale ku bëhet fjalë për “hetimet paraprake”, parashikojnë rolin që ka prokurori lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale, nenet 277 dhe 304, organi që drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Ky kod përshkruan një sërë detyrash, veprimesh hetimore dhe se i takon atij, prokurorit, të caktojë mënyrën e përshtatshme për mbledhjen e provave për veprën penale të dyshuar duke orientuar në këtë drejtim edhe policinë gjyqësore. Në përfundim të fazës së hetimeve paraprake ai konkludon bazuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, me pushimin e çështjes ose me dërgimin e saj në gjyq.
73. Pavarësisht këtij roli, që legjislati procedural i ka dhënë prokurorit në hetimin penal, dhe pavarësisht që “gëzon” ai në këtë proces, ky rol i tij, nga legjislati nuk është parashikuar se tejkalon atë që ka gjyqtari i seancës paraprake. Kur gjyqtari i seancës

paraprake vepron sipas nenit 332/ç të KPP, duke urdhëruar plotësimin e hetimeve, ai nuk i jep fund seancës paraprake, por urdhëron kryerjen e veprimeve të mirëfillta procedurale hetimore ndaj dhe ligjvënësi ka parashikuar që bashkë me plotësimin e hetimit, gjyqtari i seancës paraprake cakton afatin kur duhet të përfundojnë hetimet si dhe seancën e re. Edhe në rastin konkret, me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa ka vendosur kthimin e akteve prokurorit, ka përcaktuar detyrat konkrete që ai duhej të kryente, përfshirë caktimin e afatit “3 (tre) muaj” për kryerjen e tyre.

74. Sipas Inspektorit, refuzimi i prokurorit për të kryer detyrat e gjykatës është evident, ndërsa arrin në këtë konkluzion nisur nga fakti se ndonëse pretendimet mbi të cilat është bazuar edhe kërkesa e dytë për pushimin e procedimit penal, është ngritur nga ana e tij në ankimin e bërë ndaj vendimit nr. 184, datë 26.02.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Sipas tij, qëndrimi i prokurorit mbajtur në kërkesën e dytë drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit penal, datë 17.06.2021, ku lidhur me disponimin e parë të gjykatës bërë në Vendimin nr. 184, datë 26.02.2019, kryerja e një akti tjetër ekspertimi është e panevojshme madje e “tepërt”, është në kundërshtim të hapur me detyrat e lëna nga gjykata, për sa kohë që nga vendimmarrjet e gjykatave, si ajo e apelit ashtu dhe ajo e shkallës së parë kanë qenë në një qëndrim lidhur me domosdoshmërinë e kryerjes së detyrave nga ana e organit procedues. Çdo mendim ndryshe që ka pasur prokurori lidhur me ecurinë e dosjes dhe veprimeve që duhet të kryente, janë ngritur nga ana e tij në ankimin e bërë pranë Gjykatës së Apelit dhe kanë marrë përgjigje nga kjo e fundit.
75. Qëllimi kryesor i veprimtarisë hetimore është mbledhja e provave për veprën penale të dyshuar. Kodi i Procedurës Penale parashikon që, në gjykatë pranohen vetëm provat e mbledhura në përputhje me rregullat procedurale. Prandaj, një nga aspektet kryesore ku roli drejtues i prokurorëve bëhet më i rëndësishëm është të sigurohet që veprimet hetimore të qëndrojnë gjithmonë brenda caqeve ligjore të rëndësishme për pranueshmërinë dhe përdorimin e provave në gjykatë, si dhe për respektimin e të drejtat themelore të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve. Për të rritur shanset e një hetimi të suksesshëm, prokurori duhet të ketë një qasje sa më gjithëpërfshirëse për veprën e dyshuar dhe rrethanat e saj, pavarësisht nga fakti që në fund të hetimit mund të mos jetë në gjendje të provojë disa nga aspektet e çështjes.
76. Në këtë këndvështrim, edhe në rast të një bindje të prokurorit, si në rastin konkret, se detyrat e lëna nga gjykata janë kryer më herët në një procedim tjetër, në kushtet kur gjykatat e niveleve të ndryshme kanë mbajtur qëndrim të kundërt me bindjen e prokurorit, prokurori do të duhej të vijonte të zbatonte detyrat e lëna nga gjykata, si një mundësi, një prerogativë për të mos çuar një dosje drejt një kolapsi me pasoja për palët.
77. Sikurse rezulton edhe nga raporti hetimor sa i përket kohëzgjatjes së hetimit penal, nuk konstatohet që në fazën fillestare të tij të ketë mosveprime të prokurorit me pasojë zvarritjen e procesit. Ndërsa materialet e kallëzimit penal nr. 1167/2018, i kanë kaluar me

shortin e datës 20.06.2018, prokurorit Kledian Llaho, ditën pasuese, datë 21.06.2018, prokurori i çështjes, ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a dhe neni 186 i Kodit Penal dhe ka caktuar oficerin e policisë gjyqësore që ngarkohet me këtë hetim. Ndonëse do të duhej që pas caktimit të oficerit të policisë gjyqësore t’i caktonte këtij të fundit edhe veprimet hetimore që duhej të kryente, kjo gjë ka ndodhur vetëm pas pothuajse 3 muajve, më datë 10.09.2018.

78. Pavarësisht këtij fakti, kohëzgjatja e hetimit, e cila ka përfunduar me dërgimin e dosjes për gjykim më datë 12.12.2018, parë vetëm në aspektin kohor të saj, pa u futur në kohën që kërkohet në dispozicion për të kryer veprimet hetimore që janë kryer, konsiderohet se nuk ka zvarritje, kjo edhe duke marrë në konsideratë se gjatë kësaj periudhe kemi edhe vendim të drejtuesit të prokurorisë për bashkim me këtë procedim penal edhe të procedimit penal të regjistruar me nr. 1979 të vitit 2018 që hetohej nga një prokurore tjetër, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
79. Nëse shikohet veprimtaria prokurorit nën këtë hetim disiplinor, sa i përket kohëzgjatjes së kryerjes së veprimeve hetimore në funksion të këtij hetimi, pas kthimit të akteve nga gjykata, duke parë veprimet e prokurorit nga momenti i vendosjes në dispozicion të dosjes së procedimit penal kthyer nga gjykata më datë 10.06.2019, deri në dërgimin e saj përsëri në gjykatë më datë 17.06.2021, rezulton se ka kaluar një afat mbi dyvjeçar deri në vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal.
80. Në rastin konkret, gjatë hetimit të kallëzimit penal të shtetases Edja Seraj, prokurori nuk ka regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, dhe se përgjatë gjithë këtij hetimi nuk është konkluduar në një emër të tillë. Regjistrimi i emrit të tij do të bënte të ndiqeshin afatet e parashikuar nga nenet 323 dhe 324, të Kodit të Procedurës Penale. Por pavarësisht kësaj, prokurori pa shkaqe të përligjura nuk ka kryer veprimeve për një periudhë gati dyvjeçare.
81. Sipas Inspektorit, ka zvarritje të pajustificuar të hetimit paraprak duke mos i kryer veprimet hetimore në kohë dhe në dinamikë, në periudhë të gjatë kohore, pa pasur arsye ligjore, si dhe nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e saj në një kohë sa më të shkurtër, duke marrë në konsideratë edhe llojin e procedimit, i cili nuk ka qenë kompleks. Sipas tij, prokurori ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe një mënyrë pune që ka cenuar pozicionin e tij si prokuror, duke e konsideruar këtë si një shkelje në veprimtarinë e tij, në referim të nenit 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit “Për statusin”.
82. Sipas Inspektorit, shkelja disiplinore në kuptim të nenit 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit “Për statusin”, nuk arriti të provohet.
83. Moszbatimi i detyrave të lëna nga gjykata si në lëndën e saj ashtu dhe në një afat të përcaktuar, ka pasqyruar si pasojë mos përmbushje të funksionit dhe zvarritjen e

JEKRV

pajustificuar të procesit hetimor, nga ana e prokurorit. Në analizë të rrethanave dhe fakteve të ndodhura nuk mund të provohet një lidhje shkakësore e drejtpërdrejtë midis mosveprimit të prokurorit dhe një dëmi real për palën kallëzuese, përtej asaj të zvarritjes të procesit hetimor ardhur si pasojë e një vonese të pajustificuar, e cila provon kryerjen e shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit “Për statusin”.

84. Në arritjen e këtij konkluzioni, ndihmon edhe fakti se për pretendimet e palës kallëzuese, ka pasur më herët një hetim penal, bazuar në kallëzimin e saj, fakt ky i evidentuar edhe nga prokurori subjekt i këtij hetimi disiplinor, si në vendimet për mbylljen e procedimit penal ashtu dhe në parashtrimet e tij në kuadër të këtij hetimi disiplinor. Rezulton se në përfundim të këtij hetimi të mëhershëm, është konkluduar me pushimin tij nga ana e organit të akuzës. Sipas Inspektorit nuk mund të konkludohet se palës kallëzuese i ka ardhur një dëm si pasojë e drejtpërdrejtë nga veprimet a mosveprimet e prokurorit, pasi edhe nëse prokurori do të kryente të gjitha detyrat dhe brenda afatit të lënë nga gjykata, kjo nuk do të thotë se edhe me kryerjen e tyre, do të provoheshin si të drejta pretendimet e saj, për ekzistencën e veprës penale.
85. Në rastin konkret, nuk provohet lidhja e drejtpërdrejtë që nga mosveprimi i prokurorit Kledian Llaho, të ketë ardhur si pasojë një dëm për palët në procesin hetimor, sipas kërkesave të nenit 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit “Për statusin”, ndaj rezultatet e hetimit disiplinor lidhur me këtë shkelje të çojnë drejt përfundimit të pamjaftueshmërisë së provave për të provuar shkeljen disiplinore për këtë shkak hetimi disiplinor për këtë shkelje duhet të mbyllet në zbatim të nenit 134, pika 1, shkronja “a” të ligjit “Për statusin”.
86. Nga sa më sipër, në rastin konkret konstatohet se prokurori me veprimet/mosveprimet dhe sjelljen e tij, nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga gjyqtari i hetimeve paraprake të konfirmuara si të drejta nga gjykata më e lartë, duke përmbushur në këtë mënyrë kriteret e shkronjave “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 102, të ligjit “Për statusin”. Në rastin konkret, sipas Inspektorit rezulton se plotësohen kushtet e parashikuara për t’u konsideruar si shkelje disiplinore, pasi nga ana e prokurorit nuk janë përmbushur funksionet e prokurorit gjatë hetimit.
87. Sipas Inspektorit, nga hetimi disiplinor rezulton se shkeljet të konstatuara nuk lidhen vetëm me veprimtarinë e tij profesionale dhe që mund të jenë të rëndësishme vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të tyre, por janë të natyrës që magjistrati duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.
88. Në analizë të çështjes lidhur me kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, vlen të theksohet se në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin” nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda. Në përmbajtje të neneve 106-111, të ligjit “Për statusin”, të ndryshuar, që japin përshkrimin e

masave disiplinore, janë parashikuar konceptet e shkeljes së lehtë, të rëndë dhe shumë të rëndë, në raport me secilën masë disiplinore.

89. Këto parashikime kanë dalë në zbatim të nenit 148/d, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës ku parashikohet që prokurori mban përgjegjësi sipas ligjit. Në këto kushte arrihet në përfundimin se për të arritur në një përfundim të qartë në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115, i ligjit “Për statusin” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor.
90. Në nenin 115, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohen në mënyrë joshteruese, si kriterë për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme
91. Në analizë të kriterit “mbi llojin dhe rrethanat e shkeljes” rezulton se në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se në rastin konkret, nga ana e prokurorit Kledian Llaho, janë ndërmarrë veprime dhe mosveprime, të cilat kanë të bëjmë me mos përbushje të pajustificuar të funksioneve gjatë hetimit, duke sjellë zvarritje të akteve procedurale, të cilat janë të detyrueshme për zbatim. Rezulton e provuar se nga ana e prokurorit nuk janë mbajtur në konsideratë detyrat e lëna nga gjykata dhe kryerja e tyre brenda një afati optimal. Këto veprime/mosveprime parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 101, pika 1, shkronja “a” dhe neni 102, pika 1, shkronjat “ç”, dhe “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.
92. Karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së një procedure vlerësohet sipas rrethanave të çështjes, të cilat kërkojnë një vlerësim tërësor. Nëse fillimisht, veprimet hetimore nga ana e prokurorit janë zhvilluar në një kohë, që mund të konsiderohet optimale dhe me një ritëm të pranueshëm, kohëzgjatja në plotësimin e detyrave të lëna nga gjykata, tejkalon “afatin e arsyeshëm”, për shkak se kjo çështje nuk mund të konsiderohet komplekse si dhe në kushtet kur prokurori nuk ka kryer asnjë veprim për një periudhë 2 vjeçare duke mbajtur të njëjtin qëndrim edhe pse gjykatat e të dy niveleve kanë argumentuar të kundërtën. Sa i përket “zvarritjes së pajustificuar”, mund të mos arrihej në këtë konkluzion, nëse prokurori, në një kohë të shpejtë, duke respektuar afatin 3 mujor të caktuar nga gjykata do të depozitonte të njëjtin qëndrim, për pushimin e procedimit penal, siç dhe e ka shprehur.

93. Sipas Inspektorit, nga tërësia e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor provohet se nga ana e prokurorit Kledian Llaho, është kryer shkelja disiplinore e parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit “Për statusin”, ku parashikohet: “ç) mos përmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;” dhe “d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale”.
94. Në mbështetje të nenit 3, të ligjit “Për statusin”, një ndër vlerat themelore të deklaruara është pavarësia e magjistratit. Pavarësia në ushtrimin e funksioneve të prokurorit i referohet pavarësisë së brendshme dhe të jashtme. Pavarësia e brendshme lidhet me pavarësinë e çdo individi magjistrat për të ushtruar funksionet që lidhen me pozicionin e tyre. Ky parim parashikohet edhe në nenin 148/d, pika 2 të Kushtetutës ku thuhet se: “Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit”.
95. Magjistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin procedural penal. Magjistrati mban përgjegjësi sipas ligjit dhe një qasje e tillë, në përputhje me parashikimet e nenit 148/d, pika 1 të Kushtetutës është reflektuar edhe tek përmbajtja e shkeljes disiplinore të parashikuar në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe në nenin 102, pika 2, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit “Për statusin”.
96. Në analizë të kriterit të “shkallës së fajësisë dhe motivi”, vlerësohet se faji si një element i përgjegjësisë disiplinore, duke qenë se ka të bëjë me qëndrimin subjektiv të magjistratit ndaj kryerjes së shkeljes disiplinore si dhe pasojave të ardhura në lidhje me këtë shkelje disiplinore, nuk mund të provohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me prova dokumentare. Për të përcaktuar ekzistencën dhe formën apo shkallën e fajit duhet të analizohen rast pas rasti rrethanat të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e shkeljes disiplinore. Në lidhje me sa më sipër vlerësohet se faji si element i domosdoshëm i përgjegjësisë disiplinore përmban në vetvete dy momente: atë intelektual dhe atë që lidhet me vullnetin. Në varësi nga karakteri i këtyre dy momenteve është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë. Shkalla më e lartë e elementit të vullnetit është dashja e drejtpërdrejtë, në të cilin magjistrati ka vetëdije të plotë të realitetit faktik, duke e reflektuar dhe e vënë atë në qendër të analizës. Për këtë arsye për të përcaktuar anën subjektive të kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë analizuar rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore.
97. Sipas Inspektorit, nga të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit disiplinor rezulton se, mosveprimet e prokurorit janë kryer me faj me dashje direkt, pasi vetë prokurori, me vetëdije të plotë dhe bindje, nuk ka përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat. Duke lënë pa veprime dosjen hetimore për një periudhë mbi 2 vjeçare e duke e çuar ndjekjen penale në parashkrimin e saj, parashikuar në nenin 66 të Kodit Penal, ku afatet e parashkrimit janë 5 vjeçar, për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Ndërtim i paligjshëm

parashikuar nga nenet 186 dhe 199/a të Kodit Penal. Edhe pse në analizë të veprimeve/mosveprimeve dhe sjelljes së prokurorit nuk mund të konkludohet ekzaktësisht për pasojën reale dhe konkrete që i ka ardhur kallëzueses, mbeten evidente pasojat e mosveprimit për sa i përket, mosrealizimit të funksionit të prokurorit, moszbatimit të urdhërimit të gjykatave të mbështetura në nenin 332/ç të Kodit të Procedurës Penale.

98. Ndërsa në analizë të kriterit “pasojat e shkeljes” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor, si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit është cenuar prestigji i figurës së prokurorit, si dhe është cenuar besimi i publikut të drejtësia referuar tek vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4, të ligjit “Për statusin”. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.
99. Në analizë të kriterit “masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton një sjellje e papërshtatshme e një prokurori, duke mos respektuar vendimmarrjet e gjykatës, e cila ka autoritetin për të vendosur në lidhje me ecurinë e hetimeve paraprake, vonesa në kryerjen e veprimeve.
100. Në analizë të kriterit “sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit” apo “sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij”, rezulton se sjellja e magjistratit ka qenë bashkëpunuese.
101. Sa i përket pretendimit për shkelje të afatit tremujor nga marrja e ankesës ky afat duhet parë në raport me ndikimin që ka tek magjistrati dhe pozita e tij në këtë hetim disiplinor. Kjo për shkak se në vlerësim të Inspektorit, ky afat i është vënë në dispozicion organit të hetimit disiplinor në mënyrë që të marrë një vendim për arkivimin e ankesës ose për të filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit. Ky afat nuk mund të konsiderohet si një afat prekluziv me tejkalimin e të cilës organi i hetimit disiplinor nuk ndërmerr asnjë veprim të mëtejshëm ndaj magjistratit por automatikisht arkivon shkeljet disiplinore të pretenduara në ankesë ndaj magjistratit. Ndaj hetimi disiplinor sa i përket tejkalimit të afatit 3 mujor nga marrja e ankesës, nuk e bën procesin të paligjshëm në kuptim të nenit 109, shkronja “b” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, për sa kohë që nuk rezulton se tejkalimi i afatit 3 mujor, të ketë sjellë pasojë në përkeqësimin e pozitës së prokurorit/magjistratit dhe, për rrjedhojë, të ketë cenuar të drejtat e tij të ligjshme.
102. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe organi më i lartë vendimmarrës në juridiksionin disiplinor, Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili në Vendimin nr. 1, datë 20.02.2023 ka theksuar, ndër të tjera se: “... Së dyti, neni 109, germa “b” i ligjit 44/201536 nuk bën dallim mbi dispozitat e detyrueshme për procedurën administrative, duke paraparë që në parim të gjitha rregullat e parashikuara kanë të njëjtën rëndësi. Humbja e afatit procedural 3 mujor të përcaktuar nga ligji për arkivimin e kërkesës apo fillimin e procedimit disiplinor, nuk ka sjellë pasojë në përkeqësimin e pozitës së magjistratit, e për rrjedhojë, të ketë cenuar të drejtat e tij të ligjshme dhe as të ketë ndikuar në rezultatin substancial të procedurës, prej tij nuk është ushtruar ankim ndaj këtij vendimi dhe në seancë dëgjimore nuk është

pretenduar për ndonjë pasojë të ardhur. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se procedura administrative ka ndjekur kursin e saj normal dhe është përmbyllur me vendimmarrje të ILD-së në një afat më të shkurtër se afati i përcaktuar në ligj. Ligji nr. 96/2016, në nenin 138, paragrafi 4, parashikon se: Këshilli shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen dhe në kuptim të kësaj dispozite, nuk merr relevancë shqyrtimi i humbjes së një afati ligjor për shkaqe objektive dhe pa pasoja për palën apo për zhvillimin e procedurës, përkundrejt faktit të përmbylljes së procedurës së hetimit disiplinor në një afat më të shkurtër se ai ligjor”.

103. Lidhur me pretendimet e prokurorit për një ngarkesë të madhe të punës dhe burimet e kufizuara që ka pasur zyra e prokurorisë, çka e bën të vështirë të vendosë prioritete se cilat dosje duhet të hetojë fillimisht, nga të dhënat e dërguara lidhur me ngarkesën për vitet 2019, 2020 dhe 2021, rezulton me më shumë ngarkesë, në raport kjo edhe me kolegët e tjerë, duke u radhitur prokurori që ka më shumë çështje se prokurorët e tjerë. Kjo ngarkesë ka ardhur edhe si pasojë e mosfunksionimit në mënyrë të plotë të organikës së prokurorisë. Një ngarkesë e tillë mund të përbëjë vështirësi në caktimin e prioriteteve në tërësi të veprimtarisë së prokurorit, por në rastin objekt hetimi kjo ngarkesë është relevante, pasi nga ana e prokurorit është refuzuar me dashje të kryhen veprimet hetimore të përcaktuara qartë nga ana e gjykatës, si dhe afati për kryerjen e tyre, si dhe në të njëjtën kohë, nuk është se nuk ka vepruar për shkak të ngarkesës së punës apo ndonjë shkak tjetër, i cili nuk varej prej tij në kuadër të organizimit dhe funksionimit të organit të prokurorisë.
104. Pretendimi i prokurorit se çështja është konflikt i pastër juridiko-civil lidhur me fokus pronësinë dhe se Kushtetuta nuk e ka parashikuar prokurorinë si një organ për zgjidhje të çështjeve të pronësisë, shkak për të cilën ka nisur ky hetim disiplinor ka në thelb pretendime lidhur me veprime/mosveprime dhe sjellje të prokurorit në kryerjen e veprimeve hetimore në një procedim penal në një kohë të caktuar, gjë e cila është detyrë tipike e prokurorisë.
105. Sa i përket pretendimeve lidhur me vendimmarrjen e prokurorit dhe gjykatës në fazën e seancës paraprake, rolin e gjyqtarit të seancës paraprake në kontrollin e plotësisë së hetimeve dhe detyrimin e prokurorit për t'i zbatuar, siç e kemi theksuar më sipër në këtë raport, ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale, kanë parashikuar “seanca paraprake”, si një fazë filtri dhe kontrolli mbi veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit, ku gjyqtari i seancës paraprake, ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit.
106. Pra detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është kontrolli, nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e pa përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve. Pjesë e kompetencës së këtij gjyqtari të seancës paraprake është edhe e drejta që të urdhërojë prokurorinë për plotësimin e hetimeve duke përcaktuar dhe drejtimin e tyre, referuar nenit 332, shkronja “ç”, të Kodin e Procedurës Penale. Ndaj, pavarësisht rolit dhe pavarësisë që

ka prokurori gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, ai duhet, kur urdhërohet, të veprojë duke plotësuar detyrat e lëna nga gjyqtari i seancës paraprake.

107. Duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 101, pika 1, shkronja “a” dhe neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit “Për statusin”; (ii) rrethanat e shkeljes së kryer të cilat kanë të bëjnë me mospërbushjes e pajustificuar e funksioneve gjatë hetimit dhe vonesa që sjellin zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale; (iii) formën e kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkt; (iv) përvojën e gjatë të magjistratit në sistemin gjyqësor, si dhe vlerësimet e tij profesionale; (v) pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me respektimin e afatit të përfundimit të hetimeve paraprake në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit procedural penal; (vi) cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; (vii) ekzistencën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magjistrati subjekt hetimi disiplinor, por rrezikon të ndiqet si shembull nga magjistratë të tjerë si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme; (viii) magjistrati nuk ka masë disiplinore për një shkelje disiplinore të mëparshme në fuqi, si dhe nuk ka kryer shkelje tjetër disiplinore; (ix) ngarkesa me çështje si një shkak që është jashtë kontrollit të magjistratit, por që nuk ka ndikuar në rastin objekt hetimi disiplinor, Inspektori ka arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e prokurorit Kledian Llaho përbëjnë shkelje disiplinore nga neni 101, pika 1, shkronja “a” dhe neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit “Për statusin”, në rastin konkret përbëjnë “Shkelje të rëndë disiplinore”.

108. Në analizë të çështjes lidhur me llojin e masës disiplinore paraprakisht vlerësohet se ligji “Për statusin”, i referohet sanksionit disiplinor me termin “masë disiplinore”. Sipas parashikimeve të nenit 105 të ligjit “Për Statusin”, konstatohet se kjo dispozitë kërkon që masa disiplinore të parashikohet nga ligji si dhe detyrimin për caktimin e masave disiplinore të vendosura në këtë dispozitë. Në të njëjtën kohë, për të mundësuar zbatimin e parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizimit dhe proporcionalitetit, ligji parashikon një listë prej 6 masash disiplinore (nga më e lehta te më e rënda), me qëllim që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij dhe në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer.

109. Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj prokurorit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer.

110. Sipas Inspektorit, në rastin konkret është arritur në konkluzionin se, veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e prokurorit Kledian Llaho duhet të kategorizohen si shkelje e rëndë

disiplinore, pasi janë veprime/mosveprime të kryera me dashje nga ana e tij. Në këtë rast duhet të jepet masa disiplinore e parashikuar nga neni 105, pika "c", e ligjit "Për statusin" pasi ashtu sikundër parashikohet nga dispozitat, masat disiplinore "Vërejtje konfidenciale" apo "Vërejtje publike", aplikohen në rastet e masave të lehta disiplinore. Në analizë të masës disiplinore të kërkuar, duhet theksuar faktin se vërtetë flitet për një rast të izoluar të magjistratit të hetuar, por qëndrimi i tij edhe gjatë hetimit, thekson faktin që me dashje magjistrati nuk i është bindur një vendimi gjyqësor, detyruar për të, si dhe kjo mosbindje është reflektuar në mungesën e veprimeve të prokurorit në lidhje me çështjen hetimore.

111. Pikërisht ky mosveprim i prokurorit, refuzimi i plotësimit të detyrave të lëna nga gjykata dhe bindja e krijuar mbi çështjen hetimore, krijon kushtet për të besuar se prokurori priret t'i qëndroje bindjes së tij, pavarësisht mundësisë të shkeljes së funksioneve të tij gjatë kryerjes së detyrës. Në këto kushte vlerësohet se masat disiplinore më të lehta janë të papërshtatshme për rrethanat e kësaj shkeljeje disiplinore të kryer nga ana e prokurorit dhe nga ana tjetër këto rrethana nuk mund të klasifikohen si shkelje disiplinore shumë e rëndë e prokurorit, ndaj nuk është e përshtatshme dhënia e një masë shumë të rëndë disiplinore sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin". Sa më sipër konkludohet se për këtë shkelje disiplinore, në këto rrethana të kryerjes së saj, për prokurorin përgjegjës duhet dhënë masa disiplinore "Ulje e përkohshme e pagës".

112. Sipas Inspektorit, veprimet/mosveprimet e ndërmarra e prokurorit Kledian Llaho përbëjnë "Shkelje të rëndë disiplinore", dhe bazuar në nenet 105, pika 1, shkronja "c" dhe 108, të ligjit "Për statusin" duhet të jepet masa disiplinore "Ulja e përkohshme e pagës".

113. Në përfundim të procedimit disiplinor nga palët në proces është kërkuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë të vendosë:

- Inspektori kërkoi masën disiplinore "Ulje e përkohshme e pagës", parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja "c" dhe neni 108, i ligjit "Për statusin", në masën 40 % (përqind) të pagës për një afat një vit".
- Magjistrati Klodian Llaho kërkoi "rrezimin e kërkesës" së ILD për procedim disiplinor si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe për shkak se faktet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

114. Në përfundim të procesit disiplinor, pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga palët në datë 16.01.2025, Komisioni Disiplinor mban qëndrimin si vijon:

115. Në përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të magjistratëve prokurorë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mban parasysh parimet kriteret ligjore për caktimin e masës disiplinore.

116. Në nenin 101, pika 2, të ligjit "Për Statusin", parashikohet se: "Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh:

- a. shkalla e pakujdesisë;

SEK

- b. shpeshhtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;
- c. përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;
- ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe

d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.”

117. Sipas Inspektorit, prokurori Kledian Llaho nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në Vendimin nr.269, datë 02.05.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Subjekti i procedimit disiplinor, prokurori Kledian Llaho ka paraqitur argumentin se ka zbatuar detyrën e parë të caktuar nga kjo gjykatë duke administruar Akt Ekspertimin teknik-inxhinierik (përfshirë në vendimin nr. 1303 datë 18.4.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë) si dhe akte nga një dosje tjetër penale e përfunduar. Pas marrjes së këtyre provave, ai ka përpiluar përsëri kërkesën për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. 1167/2018. Në vlerësimin e tij profesional, detyrat e caktuara nga gjykata janë plotësuar, bazuar edhe në nenin 71, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se: “Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit.”
118. Komisioni vlerëson se moszbatimi i drejt për drejtë i detyrave të urdhëruara nga ana e Gjykatës, përbën shkelje disiplinore, sipas parashikimit të neni 102, pikat ç) dhe d) të ligjit për statusin, e cila e ngarkon me përgjegjësi prokurorin subjekt procedimi.
119. Sa i takon klasifikimit të shkeljes disiplinore, merren në konsideratë parashikimet e neni 101, pika 2 e ligjit për statusin. Dhe konkretisht sa i takon elementëve të anës subjektive, (shkalla e pakujdesisë) vlerësojmë se vërtetë s’jemi para “dashjes direkte” për mosveprimin apo refuzimin për të zbatuar detyrat e lëna nga gjykata nga ana e prokurorit, por kjo lidhet me bindjen e brendshme dhe qëndrimin profesional të prokurorit, në kuadër të pavarësisë në ushtrimin e funksionit të tij.
120. Nisur nga kjo bindje, prokurori, kërkesën e dytë për pushimin e procedimit penal, prokurori e ka arsyetuar me faktin se sipas vlerësimit të tij detyrat e lëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, janë ezauruar nëpërmjet administrimit të akteve të procedimit penal nr. 576 të vitit 2017, si dhe nga akti i ekspertimit, administruar nga dosja e procesit civil nr. 319, e vitit 2018.
121. Moszbatimi eventual i vendimit të dytë të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila rikthen për hetime çështjen penale, do të përbënte shkelje të rëndë disiplinore.
122. Për rrjedhojë, gjykojmë se nuk jemi përpara “shkeljes së rëndë” profesionale të prokurorit subjekt procedimi disiplinor, sikurse pretendohet nga ana e Inspektorit. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh faktin se dhe pasi çështja është marrë për veprim nga prokurorë të tjerë nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga prokurori tjetër që kishte çështjen e cila është mbajtur në hetim për një afat prej 1 (një) vit, 7 (shtatë) muaj dhe 6 (gjashtë) ditë pa veprime hetimore dhe më pas ka hequr dorë me arsyen se është shprehur më parë me vendimin e pushimit të çështjes penale.

123. Lidhur me kriterin tjetër ligjor që është “shpeshhtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes” rezulton se, prokurori Kledian Llaho nuk rezulton të jetë proceduar apo të jetë marrë masë disiplinore në raste të tjera gjatë ushtrimit të detyrës së tij si prokuror, e lidhur kjo edhe me kriterin tjetër ligjor që është përvoja e konsiderueshme profesionale prej 10 (dhjetë) si magjistrat prokuror dhe 14 (katërmëdhjetë) vite e 4 (katër) muaj si oficer i policisë gjyqësore (gjithsej 24 vite si nëpunës i sistemit të drejtësisë). Inspektori pranon se “vërtet flitet për një rast të izoluar të magjistratit ..” dhe se bëhet fjalë vetëm për një procedim penal të hetuar pra, ky është një rast i izoluar dhe jo i përsëritur i veprimeve të magjistratit (pika 48, e raportit të Inspektorit). Për rrjedhojë, nuk u provua “mos përmbushja” “e përsëritur” e funksioneve gjatë hetimit nga ana e prokurorit. Në dosjen personale nuk ka masa disiplinore të dhëna ndaj tij.

124. Sa i takon kriterit ligjor të “dëmtimit, mundësisë së shkaktimit të dëmtimit ose shkallës së pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi”, sikurse pranoi edhe vetë Inspektori se, “nuk mund të konkludohet ekzaktësisht për pasojën reale dhe konkrete që i ka ardhur kallëzueses, mbeten evidente pasojat e mosveprimit për sa i përket, mosrealizimit të funksionit të prokurorit, moszbatimit të urdhërimit të gjykatave të mbështetura në nenin 332/ç të Kodit të Procedurës Penale.” Nga ana e Inspektorit nuk u provuan “pasojat e rënda” në kuptim të nenit 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit “Për statusin” dhe ndaj kujt kanë rënduar ato. Nga hetimi disiplinor nuk janë identifikuar pasoja reale dhe konkrete të shkaktuara të palës ankuese.

125. Në analizë të kriterit “çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë”, efektet e pandemisë “COVID-19”, nga muaji mars 2020 deri në pranverën e vitit 2022 ka ndikuar ndjeshëm në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe nuk mund të mohohen në bazë të parimit “fakt i njohur botërisht”. Njëkohësisht, në periudhën në fjalë, sistemi i prokurorisë ka punuar në kushte të një ngarkese tërësisht ekstreme hetimore edhe për shkak të largimeve të shpeshta të prokurorëve nga procesi i Vetting-ut (rivlerësimit kalimtar), dhe se në ushtrim të detyrës së tij kushtetuese prokurori është përballur me vështirësi nga më të ndryshmet, me çështje penale komplekse që kërkojnë kohë, angazhim, përkushtim dhe sakrifica të shumta. Ngarkesa shumë e lartë e çështjeve penale të ndjekura nga ky prokuror është pranuar nga vetë Inspektori.

126. Nga ana tjetër në nenin 115, të ligjit “Për Statusin”, parashikohet se:

- “2. Këshilli, kur vendos masën disiplinore:*
- a. duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit;*
 - b. duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese.*

3. Rrethanat lehtësuese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë:

 - c. kur magjistrati e kryen shkëljen për herë të parë;*
 - d. kur magjistrati ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës;*
 - e. duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes, shkëlja e magjistratit ka pasur ndikim të vogël;*

SEKTA

c) kur magjistrati bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor;

d) kur magjistrati ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e saj;

dh) koha që ka kaluar që nga kryerja e shkeljes;

e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën Këshilli çmon se lehtëson shkeljen e kryer.

4. Rrethanat rënduese, sipas pikës 2, të këtij neni, janë:

f. kur shkelja kryhet më shumë se një herë, ose kur shkelja është kryer pas dhënies së një mase disiplinore për një shkelje të mëparshme;

g. kur shkelja është e vazhdueshme;

h. kur shkelja kryhet për shkak të motiveve diskriminuese;

c) kur shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta;

d) kur nxiten të tjerët për kryer shkelje ose veprime të paligjshme;

dh) kur shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë ose pozitën e cënueshme të të tjerëve;

e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër, për të cilën Këshilli çmon se rëndon shkeljen e kryer.”

127. Duhet mbajtur parasysh fakti se nuk jemi përpara një “dashjeje direkte” për mosveprimin apo refuzimin e zbatimit të detyrave të lëna nga gjykata, por përpara veprimeve me dashje por të motivuara nga bindja e brendshme profesionale e prokurorit gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Shkelja disiplinore e hetuar nga Inspektori përfaqëson një rast të izoluar dhe jo të përsëritur në karrierën profesionale të magjistratit.

128. Gjithashtu, nuk u provuan pasojat e rënda, reale dhe konkrete të shkaktuara ndaj palës ankuese, ndërkohë që duhen konsideruar edhe rrethanat e jashtëzakonshme të funksionimit të sistemit të prokurorisë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Nisur nga këto rrethana, masa e propozuar, “Ulje e përkohshme e pagës, në masën 40% të pagës për një periudhë njëvjeçare”, nuk respekton parimin e proporcionalitetit dhe raportin midis shkallës së shkeljes dhe masës disiplinore të propozuar.

129. Referuar kriterit tjetër që është ekzistenca e rrethanave lehtësuese ose rënduese në veprimet apo mosveprimet e prokurorit Kledian Llaho, bazuar në sa më sipër, Komisioni vlerëson se jemi përpara disa prej rrethanave lehtësuese si fakti se, duke patur parasysh në tërësi rrethanat e çështjes së hetuar, shkelja e magjistratit ka pasur ndikim të vogël dhe se magjistrati ka bashkëpunuar gjatë hetimit disiplinor. Njëkohësisht, nuk ekziston asnjë rrethanë rënduese që parashikon dispozita e mësipërme.

130. Në vijim të kësaj analize, vlerësojmë se nuk është provuar se në çështjen konkrete nga ana e magjistratit Kledian Llaho është kryer shkelja disiplinore e parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ku bëhet fjalë për: “ç) mos përmbushje të pajustificuar ose të përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;”; “d) vonesë të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të

veprimeve dhe/ose akteve procedurale;”. Inspektori nuk arriti për të provuar se ku qëndrojnë vonesat “e përsëritura”, vonesat “që sjellin pasoja të rënda” apo “zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale”.

131. Në përfundim, Komisioni Disiplinor, unanimitisht vlerëson se, propozimi i masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një afat një vit”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i Inspektorit nuk duhet të pranohet dhe se Këshilli duhet të vendosë masën disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b”, dhe neni 107, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 148/d, pika 1 dhe 149/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 102, pika 1, shkronja “ç” dhe “d”, neni 105, pika 1, shkronja “b”, neni 107, neni 115 dhe neni 146, pika 2, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, shkronja “a” dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë për procedimin disiplinor Nr. 1942/25 prot., datë 10.12.2024, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, germa “ç” e “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike” për magjistratin Kledian Llaho, e parashikuar nga neni 105, pika 1, germa “b”, dhe neni 107, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit Kledian Llaho, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4, i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së

Shqipërisë”, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR
Mirela Bogdani
(mendim paralel)

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Erind Merkuri
(mendim paralel)

ANËTAR
Vatë Staka

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erion Fejzulla

Mendim Kundër

Mendim kundër opinionit të shumicës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj prokurorit Kledian Llaho

Sipas raportit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe vendimit të arsyetuar nga shumica e anëtareve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), hetimi disiplinor është iniciuar për shkak të një pretendimi mbi zvarritjen e një procedimi penal dhe moszbatimin e një vendimi gjyqësor për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore.

Në thelb të këtij procedimi qëndron fakti se prokurori subjekt procedimi, sipas arsytimit të shumicës nuk ka zbatuar Vendimin nr. 184, datë 26.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 269, datë 02.05.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë

Në vlerësimin tonë, veprimet e ndërmarra nga prokurori Llaho nuk përbëjnë sjellje të qëllimshme apo shkelje të rregullave procedurale, pasi sikurse rezultoi edhe nga procesi disiplinor i zhvilluar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, prokurori nuk ka pasur asnjëherë qëllim moszbatimin e vendimit të Gjykatës. Veprimet e prokurorit pasqyrojnë një qëndrim ligjor të bazuar në interpretimin e tij të çështjes. Prokurori Llaho ka ndjekur procedurat e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe ka kërkuar pushimin e çështjes mbi bazën e provave të administruara, gjë që është pjesë e të drejtës së tij ligjore për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e një çështjeje penale.

Në këtë kuptim, veprimtaria e prokurorit nuk ka qenë një refuzim arbitrar i detyrimeve të tij, por një ushtrim i kompetencave të tij në përputhje me ligjin. Në fakt, vendimet e prokurorisë për të kërkuar pushimin e çështjes nuk janë të pazakonta dhe shpesh refuzohen nga gjykata, por ky nuk është një indikator automatik i një shkeljeje disiplinore.

Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe në standardet e përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, prokurorët gëzojnë pavarësi në vlerësimin e provave dhe ndjekjen penale të çështjeve. Debatet midis prokurorisë dhe gjykatës mbi domosdoshmërinë e hetimeve të mëtejshme janë të zakonshme dhe nuk mund të interpretohen si shkelje disiplinore pa u marrë në analizë të gjitha rrethanat me karakter objektiv dhe subjektiv që lidhen me veprimet apo mosveprimet e prokurorit.

Vendimet e gjykatave për kthimin e akteve në prokurori ndodhin rregullisht dhe nuk përbëjnë në vetvete një bazë për masa disiplinore ndaj një prokurori. Përndryshe, një praktikë e tillë do të krijonte një standard të rrezikshëm, ku çdo prokuror që përballet me vendime refuzuese të kërkesave të tij nga gjykata, do të mund të sanksionohet disiplinarisht.

Neni 101, pika 2 e Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar përcakton se:

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh:

- a) shkalla e pakujdesisë;*
- b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;*
- c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;*
- c) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe*

- d) *çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.*

Në vlerësimin tonë ky nen përcakton detyrimin e organit procedues siç është ILD, por dhe të organit vendimmarrës, KLP, që të analizojë dhe argumentojë nëse veprimet e prokurorit janë veprime që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, apo janë veprime të lidhura me veprimtarinë profesionale në ushtrim të funksionit hetimor të prokurorit, të udhëhequra nga parimi i pavarësisë profesionale, racionaliteti, eficientia etj.

Konstatohet se shumica nuk ka argumentuar përgjegjësinë disiplinore të subjektit, në raport të kritereve të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

- Në vlerësim të shkallës së pakujdesisë, sipas germës “a”, gjatë seancës dëgjimore u provua se veprimet e prokurorit nga pikëpamja objektive nuk janë kryer në formën e pakujdesisë, por janë kryer me vetëdije të drejt për drejtë sipas arsytimit të paraqitur edhe nga raporti hetimor.
- Në lidhje shpeshhtësinë e kryerjes së veprimit të konsideruar shkelje disiplinore nga ana e shumicës, (sipas përcaktimit të germës “b”), nga ana e Inspektorit, nuk u paraqit asnjë rast tjetër ku të tregohej se mos moszbatimi i vendimeve të gjykatës në lidhje me kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore, të jetë karakteristike për këtë prokuror.
- Sa i takon vlerësimin të përvojës së kërkuar nga germa “c”, prokurori ka një përvojë të gjatë pune në sistemin e prokurorisë, gjë që dukshëm tregon faktin se nuk jemi përpara një veprimi të kryer nga një prokuror i ri, por ky veprim është udhëhequr nga profesionalizmi dhe intuïta e fituar nga puna ndër vite e këtij prokurori.
- Një element thelbësor në çdo procedim disiplinor është ekzistenca e një dëmi konkret ose pasoje të rëndë. Sa i takon dëmtimit, mundësia e shkakut të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi i prokurorit (germa “ç”), nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton që vendimmarrja e prokurorit të ketë sjellë pasoja konkrete për palët, duke qenë se çështja vazhdoi të trajtohet nga prokuroria edhe pas largimit të tij, pavarësisht vendimmarrjes së prokurorit subjekt procedimi. Pra çështja është ende në hetim. Çështja ka vijuar të trajtohet brenda sistemit gjyqësor, për rrjedhojë nuk mund të themi se ky rast, aq më tepër i izoluar, mund të sjellë ndikim negativ në besueshmërinë e sistemit të drejtësisë apo pengesë në administrimin e drejtësisë. Nga ana tjetër neni 102, germa “d” e Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar përcakton se përbën shkelje disiplinore e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës, veprimet apo mosveprimet që sjellin vonesa të përsëritura, ose që sjellin pasoja të rënda, apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale. Sikurse vihet re nga një interpretim literal i kësaj dispozite, pasoja përbën kusht thelbësor për ekzistencën e kësaj shkelje disiplinore.
- Së fundmi në analizë të nenit 101, pika 2 germa “d”, që lidhet me çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë, duhet të merren në konsideratë rrethanat konkrete kur është gjendur magjistrati, të cilat kanë qenë jashtë kontrollit të tij, si: ngarkesa shumë e lartë e çështjeve, (pranuar nga vetë zyra e ILD si në fazën e hetimit disiplinor ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore), efektet e masave ligjore për parandalimin e pandemisë COVID përgjatë vitit 2020 deri në pranverën e vitit 2022 që kanë ndikuar në veprimtarinë normale të punës, jo vetëm të këtij prokurori, por të të gjithë magjistratëve. Në seancën dëgjimore të zhvilluar para KLP, rezultoi se prokurori

Llaho ka patur një numër të konsiderueshëm çështjesh dhe si rrjedhojë, ai ishte treguar përzgjedhës në mbarimin e atyre çështjeve që kishin të bënin me persona të arrestuar, me persona që u atribuoheshin vepra penale etj.

Sa më sipër ne vlerësojmë se veprimet e prokurorit, në analizë të rrethanave objektive dhe atyre subjektive përbëjnë një sjellje normale profesionale të një prokurori gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

Kjo nuk nënkupton se veprimet e prokurorit kanë qenë të drejta apo jo, pasi është Gjykata Kompetente e cila përcakton këtë çështje, por ne arsyetojmë se veprimet e prokurorit në këtë rast përbëjnë një përballje ligjore profesionale ndërmjet prokurorisë dhe gjykatës. Procedurat janë zhvilluar brenda kornizave të një debati ligjor ndërmjet prokurorisë dhe gjykatës. Fakti nëse veprimet e urdhëruara nga Gjykata, ishin apo jo të realizuara me provat e administruara në fashikull nga prokurori Llaho, është një çështje interpretimi, çka nuk çon automatikisht në përgjegjësinë disiplinore.

Në përfundim, arsyetimi për kualifikimin e veprimeve të prokurorit subjekt të këtij procedimi disiplinor, si shkelje disiplinore, si dhe dhënia e masës disiplinore “Vërejtje publike” nga shumica e anëtarëve të Këshillit ndaj prokurorit Kledian Llaho është i pabazuar, për këto arsye:

- Veprimet e tij janë brenda praktikës normale në një përballje ligjore midis prokurorisë dhe gjykatës.
- Ai ka përmbushur detyrat e kërkuara, ndonëse në mënyrë alternative.
- Nuk ka ndonjë vonesë të qëllimshme apo mospërmbushje të hapur të funksioneve të tij.
- Vendimmarrja e prokurorit është mbështetur në parimet e pavarësisë dhe diskrecionit të tij si prokuror. Sipas nenit 148/d të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, prokurori gëzon pavarësi në vlerësimin e fakteve dhe administrimin e provave. Në këtë rast, prokurori ka ushtruar diskrecionin e tij të ligjshëm për të përmbushur detyrimet e përcaktuara nga gjykata në një mënyrë alternative, që ai e ka vlerësuar si më e përshtatshme dhe e bazuar në ligj.

Sa më sipër, ne vlerësojmë se kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj magistratit Kledian Llaho, duhet të rrëzohej.

Anëtarët Kundër

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Duke qenë se nuk jemi plotësisht dakort me vendimmarrjen e shumicës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, përsa i përket masës disiplinore të caktuar, e vlerësojmë që të dalim me mendim pakice, për të shpjeguar arsyet pse mendojmë që kërkesa e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë duhej që të ishte pranuar në tërësinë e saj.

2. Përsa i përket, sjelljes së prokurorit Kledian Llaho, gjatë kohës që ishte në prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pa përsëritur rrethanat e faktit, të arsyetuar gjerësisht në mendimin e shumicës së këtij Këshilli, rezulton se sjellja e tij për të mos zbatuar vendimin nr.269, datë 2.5.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, përbën shkelje disiplinore, duke qenë se ka cënuar disa rregullime juridike të parashikuara në nivel kushtetues dhe ligjor.

3. Kështu, Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 7 të saj parashikon se *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”*. Në nxjerrjen e kuptimit të kësaj dispozite Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.19, datë 3.5.2007, ka mbajtur qendrimin se *“Në këtë dispozitë është sanksionuar një prej elementëve më të qenësishëm të parimit të shtetit të së drejtës, për të cilin bëhet fjalë që në preambulën e Kushtetutës.*

Në demokracinë si formë e qeverisjes, parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njeri-tjetrit. Pushteti gjyqësor zë një pozicion të veçantë. Ai është i pavarur në dhënien e drejtësisë. Në këtë funksion, gjyqtarët u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve. Mbi këtë bazë, krijohen raporte të caktuara ndërmjet organeve dhe institucioneve qendrore kushtetuese që përfaqësojnë një nga tre pushtetet kryesore, por duke bërë kujdes që në çdo rast të respektohet pavarësia kushtetuese e secilit prej tyre.

Përveç kësaj, Kushtetuta parashikon edhe krijimin e organeve të tjera qendrore me pozicion neutral ose të ndërmjetëm, vendi dhe roli i të cilëve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e shtetit demokratik si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Edhe këto organe të rëndësishme, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, gëzojnë pavarësi që garantohet me dispozita të veçanta të Kushtetutës. Ide qendrore mbetet shpërndarja e pushtetit shtetëror në disa organe apo mekanizma qendrore kushtetues; të cilët e ushtrojnë atë në mënyrë të pavarur, por duke krijuar gjithnjë mundësinë që secili prej tyre të kontrollohet në mënyrë reciproke. Një zgjidhje e këtillë është veçanërisht e rëndësishme dhe e domosdoshme në regjimin parlamentar të qeverisjes.

Fryma demokratike e shtjelluar më lart përshkon të gjithë Kushtetutën. Në dispozita të veçanta të saj bëhet fjalë shprehimisht për krijimin e organeve apo institucioneve të veçanta kushtetuese, të cilat kanë kompetenca të gjera dhe të rëndësishme në ushtrimin e pushtetit. Mes tyre përmenden qartësisht edhe kërkuesit dhe subjektet e tjera të interesuara në këtë gjykim kushtetues, të tillë siProkurori i Përgjithshëm (neni 149) Duke theksuar pavarësinë e këtyre organeve, është bërë kujdes që Kushtetuta të mos i lejë ata jashtë çdo lloj kontrolli. Ajo vendos raporte të caktuara mes vetë atyre si dhe mes tyre dhe organeve të tjera qendrore të pushtetit shtetëror, veçanërisht me Kuvendin. Këto raporte krijojnë mundësi për ushtrim kontrolli reciprok dhe për balancim të mjaftueshëm të pushtetit, duke u bazuar në kompetencat dhe funksionin kushtetues të secilit prej tyre”.

4. Gjithashtu, më tej, vetë Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të hershme, me vendimin e saj nr.5, datë 6.3.2009, është shprehur se “Kjo e drejtë për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t’iu drejtuar një autoriteti të pavarur dhe paanshëm, është në përputhje edhe me standartet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Në parim, ligjvënësi ia ka nënshtruar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor. ... Në fund është gjykata që ka të drejtë të shprehet për të gjitha veprimet hetimore përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatojë, nëse prokurori e ka pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.

Parë në këtë këndvështrim, vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes nuk mund të konsiderohet si vendim i formës së prerë dhe i paankimueshëm gjyqësisht. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se vendimi i pushimit të çështjes nga prokurori nuk përbën dhënie drejtësie, kjo e fundit është kompetencë vetëm e gjykatës. Pikërisht për këtë shkak, palëve në proces duhet t’u krijohet mundësia që të përballen me drejtësinë edhe në rastin kur prokurori vendos pushimin e çështjes për shkak se fakti nuk ekziston. Është gjykata që, ashtu si në rastet e tjera të përmendura në nenin 328 të KPP, do të vlerësojë bazueshmërinë e veprimeve paraprake të prokurorit dhe shkaqeve që e kanë çuar atë në marrjen e vendimit të pushimit”.

5. Bazuar në këto parashikime kushtetuese, rezultojnë qartësisht se parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve shtrihet edhe vëprimtarinë e organit të akuzës, pra të prokurorisë, e cila megjithëse është një organ i pavarur, vëprimtaria e tij kontrollohet, në kuadër të parashikimit kushtetues të “balancimit të pushteteve”, nga ana e gjykatave.

6. Përpara reformës së vitit 2017, që solli ndryshime rrenjësorë në Kodin e Procedurës Penale, ky i fundit në nenin 329 të tij parashikonte se “1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. 2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin. 3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri”. Ky parashikim iu nënshtrua interpretimit unfikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të cilat, me vendimin e tyre nr.2, datë 20.6.2013, kanë mbajtur qëndrimin se “41. Kur gjykata vepron mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit nga vepra

penale, krahas kontrollit për respektimin e kriterëve dhe rasteve të parashikuara nga neni 328 i K.Pr.Penale nga ana e prokurorit, gjykata kontrollon edhe faktin nëse organi i procedimit ka mbajtur parasysh kërkesat e të dëmtuarit gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake në raport me detyrimin që ka prokurori për trajtimin e kërkesave të të dëmtuarit që kanë të bëjnë me parashtrimin e fakteve dhe marrjen e provave lidhur me akuzën apo çështjen e ngritur. Detyrim ky, i cili buron nga neni 58, pika "3" e K.Pr.Penale. Në këtë kontekst, gjykata verifikon pretendimet e të dëmtuarit lidhur me kërkesat dhe provat e kërkuara prej tij gjatë fazës së hetimeve paraprake, duke vlerësuar njëkohësisht nëse prokurori ka vepruar ose jo, në përputhje me kriteret e parashikuara në ligj për pushimin e çështjes dhe ka paraqitur argumente të mjaftueshme ose jo, lidhur me veprimtarinë e tij hetimore.

42. Sikundër mund të vërehet, lidhur me kontrollin gjyqësor të vendimit të pushimit nga ana e të dëmtuarit, gjykata vihet në lëvizje në bazë të kërkesës ankimore dhe jo kryesisht. Në këtë kuadër, është e kuptueshme që gjykata, pasi vlerëson legjitimitimin dhe interesin e ankuesit për të kundërshtuar, krahas shqyrtimit të kërtimeve të parashtruara nga ankuesi, gjykata njëkohësisht bën edhe kontrollin e ligjshmërisë së vendimit, nëse ai është dhënë sipas përcaktimeve ligjore. Në rast se në ankimin kundër vendimit të pushimit të çështjes janë treguar veprime hetimore që sipas ligjit duhet të ishin bërë, por nuk janë kryer, është e kuptueshme që - kur kërkimet e ankuesit kanë të bëjnë me kryerjen nga ana e prokurorisë të veprimeve të tjera hetimore, të cilat vlerësohen si të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të drejtë në drejtim të ngritjes ose jo të një akuze - gjykata duhet të urdhërojë prokurorin edhe për kryerjen të këtyre veprimeve hetimore shtesë. Detyrimi për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore nuk duhet kuptuar si kapërcim i rolit dhe i funksionit të gjykatës përkundër funksionit të organit të prokurorisë. Ndonëse, prokuroria është organi i vetëm i ndjekjes penale, ky funksion duhet ushtruar në mënyrë të ligjshme dhe të barabartë ndaj të gjithëve. Mënyrë kjo që parashikon të vetmin mekanizëm kontrollues mbi ligjshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë së prokurorit, i cili konsiston në ushtrimin e kontrollit gjyqësor për të dy anët që kanë të bëjnë me funksionin e ndjekjes penale, qoftë kur nuk synohet të veprohet për ushtrimin e ndjekjes penale, ashtu edhe kur abuzohet me ushtrimin e tepruar të këtij funksioni. Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se: **Në gjykimin e çështjes me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, gjykata shqyrton, jo vetëm bazueshmërinë e kërtimeve të paraqitura nga ana e ankuesit, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorit janë respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji lidhur me pushimin e çështjes penale. Kur vendos shfuqizimin e vendimit, gjykata ka të drejtë të disponojë mbi kryerjen e veprimeve të tjera që kanë lidhje me akuzën dhe me veprimet hetimore të kryera deri në atë çast, në funksion të zbulimit të fakteve dhe të vërtetës për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit".**

7. Siç mund të konstatohet, edhe në formatin e saj fillestar, norma procedurale penale, siç ishte interpretuar nga Gjykata e Lartë, i jepte të drejtën gjykatës, që kur vihej në lëvizje mbi bazën e ankimit të subjekteve përkatëse, kundër vendimit të pushimit që merrte prokurori, të verifikonte jo vetëm pretendimet e palës ankuese, por gjithë veprimtarinë e prokurorisë për atë çështje nëse kishte qenë apo jo ligjore, si edhe të urdhëronte kryerjen e detyrave të caktuara.

8. Në kuadër të reformës në legjislacionin procedural penal, të miratuar nga Kuvendi, me Ligjin nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, të ndryshuar”, rezulton se me nenin 183, është ndryshuar neni 329, ndërsa me nenin 184, janë shtuar nenet 329/a, 329/b, 329/c dhe 329/ç në Kodin e Procedurës Penale.

9. Parashikimet e reja ligjore, në Kodin e Procedurës Penale, i kanë hequr të drejtën prokurorit që për rastin e hetimit të veprave penale që klasifikohen si krime, të vendosë vetë pushimin e çështjes, por duhet që t’ia dërgojë atë gjykatës për vendimmarrje përfundimtare. Po sipas këtyre parashikimeve, është gjykata që vlerëson ligjshmërinë dhe plotësinë e hetimeve të kryera, dhe kur nuk bindet në lidhje me to, i kërkon prokurorit që të realizojë veprime hetimore konkrete, duke përcaktuar edhe një afat për realizimin e tyre.

10. Referuar jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, mbas reformës së vitit 2017, rezulton se Kolegji Penal, me vendimin nr.00–2023–191 (39), datë 31.1.2023, ndër të tjera është shprehur se “40. Kontrolli juridiksional mbi “ushtrimin e detyrueshëm të ndjekjes penale”, prej prokurorit të pavarur, shërben për të përcaktuar nëse në hetimet paraprake janë mbledhur të gjithë elementët e domosdoshëm, me fjalë të tjera, nëse hetimet paraprake janë të plota të kompletuara përsa i përket anës sasiore dhe cilësore. Për pasojë edhe objekti i detyrimit të ushtrimit të ndjekjes penale përfshin detyrimin për të kryer hetime paraprake të plota të kompletuara. Pra, në detyrimin e prokurorit për të ushtruar ndjekjen penale, duhet që të jetë përfshirë edhe detyrimi për të realizuar hetime të plota, të kompletuara, sepse rregulli standarti i gjykimit, që prokurori, por edhe policia gjyqësore, duhet të ndjekin, është i njëjtë me atë që i imponohet gjyqtarit, në vlerësimin, sipas nenit 329/3 të KPrP, e kërkesës për “pushimin e çështjes”.

11. Siç mund të konstatohet, formulimet e reja ligjore, siç është pranuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, tregojnë që kontrolli gjyqësor, mbi “ushtrimin e detyrueshëm të ndjekjes penale”, shtrihet mbi të gjithë ligjshmërinë dhe plotësinë e veprimeve hetimore të realizuara nga ana e prokurorit.

12. Si rezultat i këtyre parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, të detajuara dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë të cituar më sipër, kur gjykata në kontrollin e veprimeve hetimore të prokurorit shprehej për kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore, prokurori ka pasur dhe ka detyrimin që ta zbatojë këtë vendim, në mënyrën dhe afatet e përcaktuara nga ana e gjykatës në vendimin e saj.

13. Kjo qasje mbështetet edhe në një normë tjetër kushtetuese, konkretisht nenit 142, pika 3, sipas së cilës “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”. Ky parashikim është mjaft i përgjithshëm dhe referuar rregullit të interpretimit sipas së cilit termave të përgjithshëm i duhet dhënë kuptimi sa më i përgjithshëm (*General-Terms Canon*), atëhere qartazi rezulton se në këtë rast, do të duhet të kuptojmë që kjo normë i shtrin efektet e saj edhe mbi vendimmarrjet e gjykatave në fushën e procedurës penale, nga ku rezulton që prokuroria, si organ shtetëror, do të duhet që të zbatojë vendimet e gjykatës, përfshirë edhe rastin kur e urdhëron që të kryejë veprime hetimore të caktuara.

14. Në rastin konkret rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin e saj nr. 184, datë 26.02.2019, lënë në fuqi më vendimin nr.269, datë 2.5.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë ka vendosur që nga ana e prokurorit, ndër të tjera se: “Kthimin e akteve prokurorit me qëllim

që të kryhen veprimet hetimore lidhur me procedimin penal nr. 1167/2018 në këto drejtime: i) të përcaktohet grup ekspertësh për të përcaktuar nëse vendimi nr. 21, datë 01.07.2013 protokolluar më datë 29, është apo jo në përputhje me “Rregulloren për Zbatimin e Studimit Urbanistik të Zonës me Përparësi Turistike Radhimë - Oriku për zonën A1 0-a/1 (miratuar me vendimin nr.12, datë 14.07.2009)” dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit”. ii) të hetohet nëse ekziston vendimi nr.21, datë 01.07.2013, prot., datë 28, nëse jo, të hetohet nëse është i falsifikuar si dhe kujt i atribuohet fakti penal. Veprimet hetimore të kryhen brenda 3 (tre) muajve”.

15. Ndodhur, përpara kësaj vendimmarrjeje Prokurori Kledian Llaho do të duhej që brenda 3 muajve t’i kishte kishte kryer këto veprime hetimore. Mos kryerja e tyre është vërtetuar me një tjetër vendim gjyqësor të formës së prerë dhe konkretisht nga vendimi nr. 75, datë 21.04.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila duke vendosur përsëri kthimin e akteve prokurorisë që i përkasin procedimit penal nr. 1167 të vitit 2018 për realizimin e veprimeve të mëtejshme hetimore nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndër të tjera është shprehur se: “Konstatohet se prokuroria është mjaftuar me administrimin e akteve të proceseve civile gjyqësore që kanë ekzistuar mes palëve kallëzuese dhe të kallëzuara, por ndërkohë **nuk ka përmbushur as detyrat e përcaktuara me vendimin nr. 184, datë 26.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që ka disponuar edhe më parë për kthimin e akteve prokurorisë. Rezulton se prokuroria nuk ka hetuar në lidhje me ekzistencën e dy lejeve zhvillimore me të njëjtat data, numër vendimi, nënshkrimi titullari lëshuar për të njëjtin subjekt ndërtues, por me parametra të ndryshëm teknik dhe kondicioneve urbanistike dhe më dy numra të ndryshëm protokollit”.**

16. Nga sa më sipër, siç rezulton nga vendimmarrja gjyqësore, nga ana e Prokurorit Kledian Llaho, duke mos zbatuar vendimin gjyqësor, nuk janë respektuar nenet 7 dhe 142, pika 3 të Kushtetutës, si edhe nenet 329, 329/a, 329/b, 329/c dhe 329/ç të Kodit të Procedurës Penale, shkelje këto që sjellin përgjegjësinë disiplinore të magjistratit, sipas Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, neni 102, pika 1, gërmat “ç” dhe “d”, që parashikojnë se “1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë: ... ç) mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit; (d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;”

17. Duke mbajtur dhe një qendrim në lidhje më anëtarët që votuan se në këtë procedim disiplinor nuk vërehen shkelje disiplinore nga ana e prokurorit Kledian Llaho, dëshirojmë të sjellim në vëmendje që Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.11, datë 2.4.2003, ndër të tjera ka mbajtur qendrimin se “Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë. Ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Kjo do të thotë se përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, **asnjë organ tjetër shtetëror, ..., nuk ka të drejtë t’i prekë ato ...**”. Ky precedent i rëndësishëm i vendosur 22 vjet më parë, i cili vijon të jetë i zbatueshëm edhe sot, tregon që asnjë organ tjetër shtetëror, përfshirë në këtë rast Prokurorinë, apo edhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë nuk mundet që të

arrijnë në një konkluzion të ndryshëm, nga gjykatat, si përsa i përket veprimeve hetimore konkrete që duhej të kryente magjistrati, por mbi të gjitha dhe veçanërisht që prokurori kishte realizuar përmbushjen e detyrave të lëna nga ana e gjykatës, për shkak se siç është konstatuar në vendimin nr. 75; datë 21.04.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, këto veprime nuk ishin kryer. Nëse, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, do të shprehej se veprimet hetimore të realizuara nga ana e prokurorit, plotësojnë detyrat që kishte lënë gjykata, kur vendosi kthimin e akteve dhe plotësimin e hetimeve, atëherë, vlerësojmë se vetë ky Këshill do të shkaktonte një mosmarrëveshje kompetencash dhe do të sillte cënim të neneve 7 dhe 142, pika 3 të Kushtetutës.

18. Përsa më sipër, bashkohemi me qendrimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që nga ana e prokurorit është kosnumuar shkelje disiplinore.

19. Por, nuk bashkohemi me qendrimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që sjellja e prokurorit, përbën shkelje të lehtë dhe për rrjedhojë duhej dhënë masa disiplinore “vërejtje publike” për arsye sepse arsyetimi në këtë rast është shumë sipërfaqësor dhe jo i thelluar. Një analizë më e detajuar e rrethanave të konsumimit të kësaj shkeljeje mendojmë se të çon në pranimin e masës disiplinore të propozuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

20. Kështu përsa i përket, nëse kjo shkelje disiplinore ishte apo jo me “dashje”, shumica ka marrë të mirëqenë sjelljen e prokurorit dhe nuk sqaron shumë rrethana të tjera të cilat jemi të mendimit që të çojnë në konkluzionin që moszbatimi i detyrave të lëna nga ana e gjykatësit ishte bërë me “dashje”. Kështu, detyrat e vendosura nga Gjykata e Apelit Vlorë, vendim ky i formës së prerë, është i datës 2.5.2019 (vendimi nr.269, datë 2.5.2019), detyrat në këtë rast ishin të qarta se çfarë veprimesh konkrete duhej që të kryente Prokurori. Ndërkohë prokurori, nuk realizoi këto detyra, por përkundrazi me akte dhe vendime që janë më të hershme në kohë se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, tenton që të shmangë detyrimet që vinin nga vendimi gjyqësor. Kështu nga ana e tij merret akt ekspertimi i realizuar në gjykimin në apel dhe vendimi nr.1303, datë 18.4.2018 i Gjykatës së Apelit Vlorë (vendim me natyrë civile). Duke krahasuar datat, rezulton se vendimi më natyrë civile i Gjykatës së Apelit Vlorë, është 13 muaj përpara në kohë, se vendimi me natyrë procedurale penale të Gjykatës së Apelit Vlorë që e detyronte këtë prokuror që të kryeje veprime të caktuara hetimore.

21. Nga ana tjetër, administrimi i procedimit penal, nr.576, i vitit 2017, ngre akoma më shumë pikëpyetje që nuk sqarohen nga ana shumicës. Ky procedim, është më i hershëm në kohë se sa vetë kërkesa për pushim që ky prokuror kishte paraqitur herën e parë në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë. Për këtë arsye, këtu ngrihet pyetja: *“Nëse procedimi penal, nr.576, i vitit 2017, kishte vlerë në këtë çështje, përse prokurori nuk e bëri pjesë të dosjes që herën e parë që realizoi hetime për të?”*

22. Gjithashtu, duke qenë se pranohet që kjo çështje penale që po hetohet, në vetvete nuk ishte komplekse, ngrihet një pyetje tjetër dhe më konkretisht: *“Përse në vitin 2019, prokurori, brenda afatit 3 mujor, nuk tërhoqi vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr.269, datë 2.5.2019 (bashkë më akt ekspertimin) dhe procedimin penal nr.576, i vitit 2017 dhe ta konsideronte të mbyllur përmbushjen e detyrave nga ana e tij, duke riparaqitur kërkesën për pushim në gjykatën e rrethit, brenda afatit të lënë prej saj?”*

23. Pakica, vlerëson se në këtë rast, shumica do të duhej që të kishte mbajtur një qëndrim të qartë dhe të arsyetuar, në lidhje me këto momente për të arritur në një konkluzion më të drejtë, nëse shkelja disiplinore ishte kryer me “dashje”, apo nga “pakujdesia”.

24. Si pakicë, nuk pajtohem edhe me konkluzionin tjetër të shumicës së Këshillit sipas së cilit edhe prokurori tjetër apo edhe prokurorë të tjerë e kanë mbajtur pa veprime këtë dosje penale për një kohë të gjatë pa kryer veprime hetimore.

25. Pa paragjykuar çfarë ka ndodhur me prokurorin/rët e tjerë me këtë çështje, këtu jemi përpara procedimit disiplinor të prokurorit Kledian Llaho dhe duhet të gjykojmë sjelljen e tij dhe jo sjelljen e prokurorëve të tjerë. E thënë më ndryshe, nuk mundet që të justifikohet një shkelje disiplinore sepse hipotetikisht, po vijon e njëjtja shkelje apo sjellje nga prokuror/ë të tjerë. Një justifikim i tillë për sjelljen e prokurorit, do të pas sillte uljen e ndjenjës së përgjegjësisë në të gjithë sistemin e prokurorisë me justifikimin e masivizimit të kësaj lloje shkeljeje.

26. Si pakicë dëshirojmë të theksojmë rëndësinë që ka parimi i sigurisë juridike, i cili shtrihet edhe përsa i përket vendimmarrjes së institucioneve kushtetuese, të cilat duhet që të jenë të qëndrueshme në qasjen që ato kanë për çështje të njëjta apo thelbësisht të ngjashme. Respektimi i vendimmarrjeve të mëparshme, e cilësuar si doktrina e “stare decisis”, garanton rritjen e besimit të publikut por edhe të prokurorëve tek institucioni i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke treguar që nga ana e saj raste të njëjta apo thelbësisht të ngjashme do t’i zgjidhë në të njëjtën mënyrë. Vetiu kjo qasje do t’i bëjë edhe prokurorët më të përgjegjshëm, duke përcaktuar që shmangia apo mozbatimi i detyrave të lëna nga gjykata, do të konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore.

27. Përsa i përket arsytimit të shumicës që justifikon sjelljen e prokurorit me ekzistencën e pandemisë COVID-19, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, pasi ky moment në gjykimin tonë, nuk mundet që të vlerësohet si një fakt i njohur botërisht i pa analizuar me të dhena shkencore dhe ligjore. Kështu, shumica nuk citon asnjë të dhënë apo provë shkencore se si ka ndikuar pandemia COVID-19 në punën e prokurorisë, në përgjithësi, si edhe të prokurorit Kledian Llaho në veçanti. Jemi të mendimit që në këtë rast, duhej të ishte marrë në konsideratë jurisprudencë e Gjykatës së Lartë, përsa i përket natyrës së fakteve “të njohura botërisht”, e cila ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se ***“Këtë konkluzion Gjykata e Apelit Korçë nuk e mbështet në asnjë të dhënë apo provë shkencore të lëshuar nga ndonjë institucion apo organ kompetent, i cili mund të konfirmojë këtë fakt që gjykata e konsideron “të njohur botërisht”. Në këto rrethana, ky arsyetim është i gabuar pa asnjë bazë ligjore, ç’ka do të thotë se dhe përfundimi i gjykatës, i mbështetur në një fakt të tillë, është i gabuar”*** (vendimi nr. 00-2009-804 i Vendimit (216), datë 16.6.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

28. Nga të dhënat e publikuara, rezulton qartësisht se masat e parë shtrenguese në kuadër të kësaj pandemie janë si më poshtë:

- Udhëri i Ministrisë së Shëndetësisë nr.132, datë 8.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo publike dhe anulimin e grumbullimeve massive në vende të mbyllura apo të hapura”.
- Udhëri i Ministrisë së Shëndetësisë nr.133, datë 8.3.2020 “Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale”.

- Udhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.134, datë 8.3.2020 “Për vetkarantinimin e personave që hyjnë në territorin e Shqipërisë nga zona e izoluar në Itali”
- Udhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.135, datë 9.3.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së Covid-19”.
- Udhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.135-1 “Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19”.
- Urdhëri nr.156, datë 10.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”.
- Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.156/2, datë 11.3.2020 “Për shpalljen e epidemisë nga infeksioni COVID-19”
- Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr.243, datë 24.3.2020 ka vendosur të shpallë gjendjen e fatkeqësisë natyrore, përse i përket kësaj pandemie.

29. Nisur nga sa më sipër, rezulton qartë që masat për pandeminë i përkasin muajit mars 2020, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Apelit që e detyronte prokurorin të kryente veprime hetimore të caktuar është i muajit maj 2019.

30. Pra, kemi një boshllëk kohor prej 9 muajsh, ku ky prokurori nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, megjithëse afati hetimor i lënë nga gjykata ishte 3 muaj. Pra, rezulton se prokurori kishte 3-fishin e kohës së lënë nga gjykata në dispozicion për të kryer veprimet hetimore përpara se pandemia COVID-19 të shtrihej në Shqipëri.

31. Nga ana e shumicës, nuk trajtohet aspak se çfarë e pengonte prokurorin që *i) Të merrte vendimin civil të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe procedimin e vitit 2017 dhe ta quante të realizuar detyrat e tij; ose në alternative ii) Të realizonte detyrat e lëna nga gjykata, ose të paktën të fillonte t'i realizonte.*

32. Nëse i rikthehemi pandemisë COVID-19, rezulton se gjendja e fatkeqësisë natyrore u zgjat me vendimin e Kuvendit nr.94, datë 23.4.2020, për dy muaj. Pra, rezulton se gjendje e fatkeqësisë natyrore për shkak të kësaj pandemie, ka përfunduar më datë 23 qershor 2020.

33. Nga ana tjetër Ministri i Shëndetësisë, me urdhërin nr.351, datë 29.5.2020 “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve përparandalimin e përhapjes së COVID-19”, ka hequr karantinimin e përgjithshëm dhe ka lejuar, me disa kushte, levizjen e lire. Në këtë kohë, në bazë të këtij urdhëri filluan dhe aktivitetet e tyre edhe gjykatat, prokuroritë, administrata publike etj. Masat e vendosura nga ky urdhër u lehtësuan me kohën (*shih urdhrat nr. 351/1, datë 22.6.2020, nr. 531, datë 28.9.2020, nr. 564, datë 9.10.2020; nr. 270/2, datë 30.6.2021 dhe nr. 208, datë 1.4.2022 të Ministrit të Shëndetësisë*).

34. Duke qenë se karantini i përgjithshëm, zgjati rreth tre muaj, është e pakuptimtë, pse kjo dosje hetimore mbetet pa veprime nga ana e këtij prokurori, për një kohë të gjatë, ku pranohet së çështja nuk ishte komplekse. Pra, nuk shpjegohet pse mbas lehtësimit të masave kufizohese nuk u realizuan, nga prokurori asnjë prej veprimeve të cituara më sipër.

35. Ndodhur përballë këtyre të dhënave zyrtare nuk rezulton që të ketë asnjë justifikim pse ky prokuror qoftë edhe në mënyrën si e konceptonte që të realizonte hetimet për këtë dosje, të mos kryente asnjë veprim para apo pas pandemisë, kur çështja nuk ishte komplekse.

36. Në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar (vetting), shumica justifikohet vetëm që ta përmendi, si argument për të justifikuar ngarkesën e këtij prokurori por pa ofruar një analizë të statistikave në lidhje me kohën e largimit të prokurorëve të ndryshëm, për shkak të këtij procesi, si edhe si ka ndikuar shpërndarja e dosjeve hetimore përkatëse tek prokurorët e tjerë.

37. Nga një verifikim, rezulton se rasti i parë, i procesit të rivlerësimit kalimtar që ka prekur Prokurorinë e Rrethit Vlorë është vendimi nr.182, datë 18.7.2019 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku bëhej fjalë për drejtuesin e kësaj prokurorie, i cili sipas rregullimeve normative nuk mban ngarkesë të madhe. Rasti i dytë i shkarkimit nga ky proces, është ai i vendimit nr.415, datë 7.7.2021 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Duke bërë një krahasim të datave rezulton se largimi i këtij prokurori të dytë nga Prokuroria e Rrethit Vlorë, ka ndodhur rreth tre javë mbasi magjistrati që po procedohet, kishte përcjellë në gjykatë, kërkesën e dytë të pushimit të çështjes.

38. Mbi këtë bazë, kur gjatë këtij procesi, rezulton që të ishte larguar vetëm drejtuesi i kësaj prokurorie, i cili nuk mbante edhe ngarkesë të madhe hetimore, jemi të mendimit që do të duhej të kishte pasur një analizë konkrete të të dhënave statistikore se si ky proces, ndikoi në ecurinë e kësaj prokurorie apo edhe në çështjet që ka pasur vetë ky prokuror. Nga ajo që u analizua më sipër, në dukje dhe *prima facie*, procesi i rivlerësimit kalimtar, për kohën kur janë shtrirë veprimt hetimore, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë ndikim në punën e përgjithshme të kësaj prokurorie, apo të këtij prokurori në veçanti.

39. Përsa i përket argumentimit tjetër të shumicës të Këshillit se në ushtrim të detyrës së tij kushtetuese prokurori është përballur me vështirësi nga më të ndryshmet, me çështje penale komplekse që kërkojnë kohë, angazhim, përkushtim dhe sakrificë të shumta, nuk rezulton që të jenë paraqitur dhe analizuar statistika, për të konkluduar sa më drejtë se sa ka qenë ngarkesa e këtij prokurori në periudhën 2018-2021, për secilin vit, të çfarë natyre janë këto çështje, si edhe, si ka qenë kjo ngarkesë në raport me prokurorët e tjerë të kësaj prokurorie.

40. Këto të dhëna do të sqaronin një kontradiktë që ekziston në sjelljen e prokurorit. Kështu, pranohet se hetimi i kësaj çështjeje, fillimisht ka zgjatur 6 muaj përpara se ky prokuror të paraqiste kërkesën e parë për pushimin e çështjes në gjykatë., kohë e cila është konsideruar si optimale në hetimin e kësaj çështjeje. Nga ana tjetër, mbasi u dha vendimi i Gjykatës së Apelit në muajin maj 2019, aludohet ky prokuror i është rritur ngarkesa në mënyrë të shpejtë sa që nuk ka pasur mundësi të merret më këtë lloj çështjeje, por pa u paraqitur dhe analizuar të dhëna konkrete në këtë drejtim.

41. Edhe referimi që ka bën shumica në gjetjet e ILD-së nuk mundet që të shërbejë si argument, duke qenë se i) Inspektori shprehet që megjithëse ngarkesën kjo nuk e pengonte prokurorin që të realizonte veprimet e tij dhe për rrjedhojë konkluzionet e ILD ose duhet të pranohen në tërësi ose të rrëzohen në tërësi dhe ii) Komisioni nuk sqaron çfarë ndodhi me ngarkesën e këtij prokurori në vitin 2021 që ai arriti të gjejë kohën të merret me këtë çështje dhe të marrë disa akte gjyqësore dhe procedurale.

42. Për këtë arsye jemi të mendimit që shumica do të duhej të rrëzonte me statistika qasjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe jo ta pranonte atë në mënyrë të pjesshme.

43. Përsa më sipër, gjykojmë që sjellja e prokurorit ka qenë e tillë, që nga ana e tij është velrësuar se në caktimin e detyrave, gjykatat kishin gabuar dhe për këtë arsye vendosi me dashje që të mos i zbatoj këto vendime. Kjo duket qartë edhe nga mbrojtja që realizoi në Këshill ky

insistonte që gjykatat nuk e kishin kuptuar thelbin e çështjes dhe përse këto veprime që ishin urdhëruar prej tyre nuk ishin të nevojshme.

44. Nga sa më sipër, për pakicën, rezulton se mos realizimi i detyrave të lënë nga ana e gjykatës nuk janë zbatuar me dashje nga ana e prokurorit, i cili ka zvarritur kryerjen e tyre për rreth 2 vjet dhe në fund është mundur që t'i anashkalojë ato me kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që nuk ishin kërkuar nga ana e gjykatës. Për këto arsyeje, sjellja e prokurorit duhej që të ishte konsideruar si shkelje e rëndë dhe masa disiplinore e propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të duhej që të ishte pranuar nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR

Mirela Bogdani



ANËTAR

Erind Merkuri

KOPJE